



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në**

**“Etika në Institucione dhe Lidërsip”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Dorianë Pano

2. Dr. Fatri Morina

Dhjetor/2022



## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidership”

Nr.		
1.	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2.	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Filozofisë
3.	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidership”
4.	Urdhëri/VKM i licensimit:	UMASH Nr. 540, datë 09.11.2012
5.	Urdhëri i riorganizimit:	UMAS Nr. 110, datë 04.03.2022 (miratimi i ofrimit të programit edhe në gjuhën angleze)*
6.	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASH Nr. 297, datë 20.07.2012
7.	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
8.	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
9.	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
10.	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
11.	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip/Anglisht
12.	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
13.	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14.	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15.	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
16.	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE / 13 PAK
17.	Numri i studentëve:	77 studentë
18.	Komente / të tjera:	

\*Sipas këtij urdhëri, veprimtaria akademike për ofrimin si gjuhë studimi edhe në gjuhën angleze, fillon sipas legjislacionit në fuqi.






## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës; 200 - 400 fjalë

Programi në proces vlerësimi është program i ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, i ofruar nga Departamenti i Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Programi i studimit është licencuar në vitin 2012, nëpërmjet Urdhrit të MASH Nr. 540, datë 09.11.2012 *“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë ‘Master i Shkencave’ në ‘Etika në Institucione dhe Lidërsip’ në Universitetin e Tiranës”* sipas Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr. 379, datë 26.10.2012 *“Për programin e studimit të ciklit të dytë që përfundon me Master i Shkencave në Etika në Institucione dhe Lidërsip”*. Ky program ofrohet edhe në gjuhën angleze, miratuar me Urdhër të MAS Nr. 110, datë 04.03.2022 *“Për miratimin e ofrimit dhe në gjuhën angleze të disa programeve të studimit në Universitetin e Tiranës”*. Programi i studimit realizohet me 120 kredite ECTS, në gjuhën shqipe dhe angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidërsip”.





## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë**

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i përbërë nga dy anëtarë: Dr. Dorianë PANO dhe Dr. Fatri MORINA, ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, i mbështetur nga Koordinatorët Teknikë të ASCAL, Msc. Ersi Dako dhe Msc. Aviola Bardhi. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Grupi, në vlerësimin e tij është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga Universiteti i Tiranës, dokumentacionin shoqërues të raportit dhe mbi vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 21-22 Korrik 2022. Po ashtu, Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, si dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, GVJ ka zhvilluar takime me përfaqësues të këtij institucioni të përfshirë në këtë proces, strukturat drejtuese të fakultetit, anëtarët e departamentit deri tek zyrat menaxheriale dhe horizontale siç janë burimet njerëzore, sekretaria e mësimore, si dhe takime me studentët e programit.

Ecuria e procesit është koordinuar nga Koordinatorët Teknikë të ASCAL-it, të cilët kanë asistuar GVJ-në dhe kanë koordinuar procesin e mbledhjes së dokumenteve shtesë të kërkuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion.

Më datë 30.11.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/161 Prot., datë 30.11.2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 19.12.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 3309/6, datë 21.12.2022.

GVJ, pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft-Raportin, sqaron si në vijim:

1. **GVJ tek Standardi II.1, Kriteri 6:** GVJ rekomandon që njëra nga lëndët ekzistuese në Kategorinë A të zëvendësohet me një lëndë për përgatitjen metodologjike (Metoda Kërkimi).

**Komenti nga IAL:** Jemi plotësisht dakord dhe marrim në konsideratë rekomandimin.

2. **GVJ tek Standardi II.5, Kriteri 1 dhe 2:** Në vitin akademik 2018-2019: 58.4% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAE, ndërsa 41.6% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAK; në vitin akademik 2019-2020: 60.9% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAE, ndërsa 39.1% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAK; në vitin akademik 2020-2021: 50% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAE, ndërsa 50% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAK; në vitin akademik 2021-2022: 54.05% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAE, ndërsa 45.95% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAK (Evidencë 4.6 gjatë vizitës\_Personeli akademik). Rekomandimi: Për




sa më lart, ngarkesa mësimore në këtë program studimi nuk mbulohet së paku 70% nga personeli akademik efektiv, sikurse kërkohet nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Institucioni duhet të marrë masa për shtimin e ngarkesës së PAE dhe reduktimin e ngarkesës së PAK, për të shkuar drejt raportit së paku 70/30.

**Komenti nga IAL:** Nuk jemi dakort me rekomandimin dhe argumentin e dhënë dhe paraqesim këtë kundërgargument: Në vitin akademik 2019-2020: 60.9% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAE, ndërsa 39.1% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAK; që do të thotë që Departamenti ka realizuar dhe përmbushur kriterin në masën e kërkuar. Pas vitit 2019-2020, pesha e pesonelit akademik efektiv PAE ka rënë në masën 50% - 54%, për shkak se pedagogu L.R, PAE në Departamentin e Filozofisë, është larguar nga Departamenti sipas një Marrëveshje me Rektorin e Universitetit të Tiranës me të drejtën që i ruhet vendi punës, me të drejtë rikthimi në Departament, brenda afatit 5 vjeçar sipas dispozitave ligjore të VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 13. Në Marrëveshjen me Rektorin, nuk cilësohet data e rikthimit në punë, për këtë argument nuk dinim afatin për të marrë masa të mëtejshme. Aktualisht data e rikthimit në Departament do të jetë me datë 31.12.2022 dhe logjikisht pedagogu do të marrë ngarkesën përkatëse për programin e studimit Etika në Institucion dhe Lidership.

**Komenti nga GVJ:** GVJ, pasi shqyrtoi argumentet e dhëna nga IAL lidhur me ngarkesën mësimore dhe raportin PAE/PAK, konkludon se:

- Kuadri ligjor parashikon se raporti PAE/PAK duhet të jetë së paku në masën 70% PAE/30% PAK. Sikurse është evidentuar edhe më parë, pranuar edhe nga vetë IAL në argumentet e paraqitura, ky raport nuk është respektuar;
- Kuadri ligjor parashikon se personeli akademik i kategorisë “Profesor” mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, për t’u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike (Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 65, pika 3). Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga IAL, pedagogu L.R. është personel akademik i kategorisë “Lektor” dhe jo i kategorisë “Profesor”. Në VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 13, nuk specifikohet kategoria e personelit akademik që përfiton këtë të drejtë, por duke u bazuar në hierarkinë e akteve ligjore, parashikimet në Ligjin e sipërcituar, duhet të aplikohen edhe në rastin konkret;
- Duke qenë se diferenca e ngarkesës midis PAE/PAK është relativisht e madhe, edhe nëse pedagogu L.R do të ishte pjesë e PAE, nuk do të arrihej të respektohej standardi për raportin 70% PAE/ 30%PAK;
- Procesi i vlerësimit të jashtëm ka si objekt periudhën nga viti akademik 2018-2019 deri në vitin akademik 2021-2022, për këtë arsye, rikthimi i pedagogut L.R. në 31.12.2022 përkon me një datë jashtë periudhës objekt të vlerësimit të jashtëm;





- Në përfundim, argumentet e dhënë nga IAL nuk vlerësohen si argumente që do të ndikonin në vlerësimin për standardet dhe fushën përkatëse, vlerësim i cili për gjithë sa më lart nuk ndryshon.
3. **GVJ tek Standardi II.5, Kriteri 1 dhe 2:** Lidhur me ngarkesën totale të personelit akademik, në të gjithë programet e studimit, konstatohet se jo gjithmonë respektohen parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Evidentohen 3 raste kur personeli akademik është i angazhuar në 7 lëndë, në programe të ndryshme studimi, në një kohë që aktet nënligjore në fuqi parashikojnë angazhim deri në 3 lëndë semestrare. Rekomandimi GVJ: Rekomandohet që institucioni të marrë masa për uljen e ngarkesës së PAE (referuar numrit të lëndëve) dhe të shtojë personelin akademik të kësaj kategorie.

**Komenti nga IAL:** Së pari, këto tre raste kanë qenë të kushtëzuara nga argumenti i mësipërm, largimi i përkohshëm i një PAE, si dhe për të marrë masa për shpërndarjen e ngarkesës së PAE në tre programet e studimit që ofron Departamenti i Filozofisë. Së dyti, nuk jemi dakord, me rekomadimin të shtohet PAE, sepse pedagogu në marrëveshje me Rektorin e UT nuk e ka të përcaktuar datën e kthimit. Së treti, kriteri nuk përmbushet për shkak të këtij legjitimitimi institucional dhe pengese që vjen nga ana ana institucionale dhe jo si pasojë e keqmenaxhimit apo mungesës së vullnetit të Departamentit për përmbushjen e këtij kriteri. Stafi akademik i brendshëm që mbulon këtë master në dy vitet e fundit menaxhon në maksimumin e eficiencës. Fakti që të angazhuarit nga stafi i brendshëm janë vlerësuar si më cilësorët e zbatimit të ofrimit të këtij cikli studimesh në gjuhë të huaj, anglisht, ka rrjedhur nga detyrimi ynë ndaj procesit të ndërkombëtarizimit dhe cilësisë ftuese për ndjekje kërkimesh dhe kërkim të studentëve dhe stafeve akademike në shkëmbimet e mundshme me Erasmus.

**Komenti nga GVJ:** GVJ, pasi shqyrtoi argumentet e dhëna nga IAL, konkludon se:


- Argumentet e dhëna nga GVJ në komentin 2 më sipër, lidhur me rastin e pedagogut L.R. aplikohen edhe në këtë rast;
- Pavarësisht rikthimit të një pedagogu me status PAE, nuk do arrihej të përmbushej standardi për një ngarkesë maksimale prej 3 lëndësh;
- GVJ ka si qëllim vlerësimin e përmbushjes së standardeve shtetërore nga IAL, për programin në proces vlerësimi. GVJ nuk ka tagër të konstatojë shkakun për mos përmbushjen e një standardi (pengesë në nivel IAL apo pengesë në nivel Departamenti), por ka si qëllim të vlerësojë nivelin e përmbushjes së standardeve dhe të japë rekomandime të cilat i gjykon të nevojshme për përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë;
- GVJ ka evidentuar dhe vlerësuar cilësinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, të cilët përmbushin parashikimet ligjore lidhur me kualifikimet e tyre, sikurse ka evidentuar edhe rastet kur personeli i angazhuar nuk ka kualifikimin në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi;
- Në përfundim, argumentet e dhëna nga IAL nuk vlerësohen si argumente që do të ndikonin në vlerësimin për standardet dhe fushën përkatëse, vlerësim i cili për gjithë sa më lart nuk ndryshon.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip”**


**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Institucioni, veprimtarinë e tij e bazon në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet e tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, të Statutit të Universitetit ( <b>Evidencë 1.2</b> ), Rregulloren bazë të tij ( <b>Evidencë 1.3</b> ) dhe akteve të tjera rregullatore të institucionit. Në qëllimet strategjike të UT përcaktohet ndër të tjera ( <b>Evidencë 1.4_Strategjia e Zhvillimit të UT</b> ): “Institucioni për të gjitha programet e studimit që ofron, ato kanë si qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës shkencës dhe ekonomisë dhe kanë një emërues të përbashkët , nxitjen e mendimit kritik dhe krijues me qëllim zhvillimin e frymës së qytetarisë demokratike, krijimin e një hapësire publike universitare që karakterizohet nga debati i lirë, serioz dhe me përkushtim ndaj të mirës publike”. Ofrimi i përgjigjeve integrale ndaj problematikave të ndryshme, nëpërmjet veprimtarive njohëse dhe promovuese, krijuese dhe kërkimore, me synim promovimin e vlerave qytetare dhe komunitare, konfirmon se programi është në harmonizim të plotë me vlerat kulturore të kombit, kjo në përputhje me etikën profesionale dhe qytetare, dhe në të njëjtën linjë me interesat kombëtare, duke mos dëmtuar në asnjë formë ato.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, përmes planit mësimor, synon të krijojë dhe kultivojë dije të kombinuara teorike dhe praktike ( <b>Evidencë 3.5, pika 3_Strategjia e zhvillimit të programit</b> ). Ky program studimi është në përputhje me vlerat kulturore të vendit dhe me etikën profesionale dhe civile, duke qenë në të njëjtën linjë me interesat kombëtare, ato të integritit evropian dhe demokratizimit, në ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të vlerave të vendit ( <b>Evidencë 3.18_Raporti Vjetore; Evidencë 5.2_Plani mësimor i programit të studimit</b> ).
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe	Misioni i programit të studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, i ofruar nga Departamenti i Filozofisë, është konceptuar dhe zhvilluar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të Institucionit, siç përcaktohet në Statutin e UT, në




fushën e veprimtarisë.	<p>strategjinë e UT dhe në planin Strategjik të programit të studimit (Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023; Evidencë 3.5_Strategjia e programit të studimit 2021-2024). Synimi i këtyre akteve normative është që ta drejtojnë zhvillimin e institucionit, në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë: kërkim shkencor, edukim si dhe shërbim ndaj publiku (Evidencë 1.2, Neni 5_Statuti i UT). Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, synimi i të cilit lidhet me nevojën për t’ju përgjigjur kërkesave të kohës dhe eliminuar përgatitjen e specialistëve me kompetencë të kufizuar, e shtrin hapësirën e specializimit, duke afruar një trajtim ndërdisiplinor.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar dhe ofron premisa për një arsim cilësor në shërbim të zhvillimit ekonomik lokal dhe atë kombëtar, duke patur në fokus përsosmërinë dhe bërjen sa më kompetitive në tregun e punës. Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip” është ndërtuar për t’ju përgjigjur nevojës që ka vendi ynë për përmirësimin e funksionimit e sektorit publik në nivel qendror dhe lokal, përmirësimin e planit mësimor, me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e ndryshme, si dhe ofrimin e praktikave për formim të vazhduar në përputhje me nevojat e profesioneve në nivel lokal dhe kombëtar. (Evidencë 3.5 Pika 5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit).</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në institucione dhe lidërsip” i përgatit studentët për të qenë në gjendje të specializohen në një fushë të caktuar të zgjedhur prej tyre, gjatë studimeve në këtë program. Studentët marrin lëndë të specializuara në fusha si: E drejta dhe Shoqëria, Etika në administratë dhe biznes, Lidërsipi dhe Standardet, dhe fusha të tjera, që i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësi të avancuara dhe kompetenca për pranimin në ciklin e tretë të studimeve doktorale (Evidencë 4.2_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë 3.6, Kreu II Neni 7, pika 2_Rregullore e programit të studimit).</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>




<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidership” i ofruar nga Departamenti i Filozofisë, është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit dhe strategjinë e njësisë bazë. Në planin strategjik të UT, por edhe në strategjinë e Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamentit të Filozofisë, për programet studimore të nivelit të II-të, në përputhje me misionin dhe vlerat qytetare të studentëve, përcaktohen qartë objektivat e përfshirjes dhe angazhimit qytetar, përsosmëria në mësimdhënie, zhvillimi i kërkimeve shkencore në dobi të shoqërisë, të gjitha këto në kuadër të përmbushjes së përgjegjësisë sociale.</p> <p><b>(Evidencë 2.3_Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023; Evidencë 1.4_Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023; Vizita në Institucion, takimi me GVB-në dhe personelin akademik të këtij programi studimi)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në statutin e UT përcaktohet se për programet e studimit në këtë institucion hapja, mbyllja dhe riorganizimi i tyre bazohet në vlerësimin e nevojave duke ndjekur dinamikën e zhvillimit të tregut të punës <b>(Evidencë 1.2, Neni 89 Statuti UT; Evidencë 1.3, Neni 31, Kreu 1_Rregullore e UT)</b>. Gjithashtu në prioritetet strategjike përcaktohet një angazhim pozitiv me këshillat lokalë dhe organizma të tjerë vendimmarrës, për një gamë të gjerë tematikash, duke përfshirë planifikimin dhe hartimin e strategjive zhvillimore, me shtrirje dhe ndikim në komunitet. Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidership” është i organizuar sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi “<i>Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i>”.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Në hartimin e programit të studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidership” është konsideruar edhe dizenjimi i tij në linjë me nivelin e kualifikimeve siç përcaktohet nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit <b>(Evidencë RVB, fq. 6 dhe 7)</b>.</p> <p>Në mënyrë më specifike emërtimi programit të studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidership” përkon me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, sikurse dhe lëndët e çështjet që trajtohen gjatë programit. Programi synon të japë aftësi për analizë kritike në këtë fushë si dhe drejtimit akademike të FSHS-së.</p> <p>Ai gjithashtu jep aftësi për të integruar njohuritë nga fusha të ngjashme në fushën e edukimit, moralit, etikës dhe lidershipit, si dhe</p>




	administrimit publik. Në kuptim të kompetencave të tjera dhe më të gjera, programi ka për qëllim të ofrojë mundësi për studentët që të jenë në gjendje të menaxhojnë proceset dhe institucionet e për të shtuar aftësitë e kontributin në dobi të shoqërisë ( <b>Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit</b> ).						
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Referuar rregullores së programit të studimit, misioni i këtij programi është t’u ofrojë studentëve mundësinë që të thellojnë dhe zhvillojnë dijet si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e etikës dhe lidërshipt, të kontribuojë në zhvillimin social dhe politik në nivel kombëtar, nëpërmjet rolit emancipues të dijeve që ofron dhe forcimin e sigurisë dhe mirëqënies publike dhe kombëtare ( <b>Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit. Pika 4; Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit, Neni 5</b> ). GVJ është i mendimit se ky program studimi është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit për rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore.						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Përmbajtja dhe rendi i objektivave të programit të studimit kanë si qëllim arritjen e synimeve të tij në përputhje me nivelin e studimeve në të cilat ofrohet. Departamenti i Filozofisë nëpërmjet programeve që ofron në të gjitha nivelet Bachelor në Filozofi, Msc. Etika në Institucione dhe Lidërshipt, Msc Filozofi Sociale, PhD Studime doktorale në Filozofi, ka një përcaktim të qartë të objektivave të çdo programi studimor në çdo nivel të ndryshëm. ( <b>Evidencë 3.3, pika 6.2.a. Fusha e mësimdhënies_Rregullore e Departamentit të Filozofisë</b> ). Në hartimin e programit të studimit, Departamenti është kujdesur që renditja e objektivave të jetë në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike, me qëllimin e programit dhe me nivelin e studimit të ciklit të dytë, të cilit i përket. Kompetencat e fituara në programin e ciklit të parë të studimit thellohen gjatë zhvillimit të këtij programi me synim specializimin e studentëve. Të diplomuarit e këtij cikli pajisen me aftësi për konstruksione logjike me bazë teorike dhe empirike, njohje të thelluara të marrëdhënieve midis institucioneve ekonomike, politike dhe kulturore, proceseve vendimmarrëse dhe








	<p>implikimeve etike të tyre. Të gjitha këto arrijnë të mbulojnë marrëdhëniet e administratës me publikun të interesuara në këto specialitete (<b>Evidencë 4.1, pika 3, Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë 3.3, pika 6.2.a. Fusha e mësimdhënies_Rregullore e Departamentit të Filozofisë; Evidencë 3.6, Kreu II, Neni 7, pika 1 Objektivat formues të programit_Rregullore e programit të studimit).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Departamenti i Filozofisë, i cili ofron programin që po analizojmë, ka kryer një studim tregu, por nga dokumentacioni i përcjellë si pjesë e DVV (<b>Evidencë 4.17_Studim tregu</b>), rezulton se ky studim tregu, nisur që nga titulli i dokumentit (<i>Studim tregu. Vlerësimi i statusit të punësimit tek studentët e Departamentit të Filozofisë të Universitetit të Tiranës. Programi Bachelor në Filozofi</i>), është për programin Bachelor në “Filozofi” dhe jo për këtë program studimi, si dhe përgjatë studimit të tregut është analizuar për degën e filozofisë dhe në rang departamenti/fakulteti. Institucioni, ka paraqitur gjithashtu si pjesë të DVV, edhe të dhëna mbi regjistrimin, ecurinë, diplomimin dhe punësimin e studentëve të këtij programi studimi për periudhën 2019-2021 (<b>Evidenca 4.8_ Të dhëna për regjistrimin, ecurinë</b>), të cilat janë të dhëna tabelore, si dhe të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve (<i>titulli i dokumentit “Orientimi dhe tendenca e studentëve të “Filozofisë” për studimet master”</i>) (<b>Evidenca 4.14_ Të dhëna për punësimin real të studentëve</b>), ku përpos programeve të tjera, jepen edhe të dhëna për hyrjen/daljen dhe punësimin e studentëve të këtij programi studimi, por të cilat nuk përbëjnë një studim të mirëfilltë të tregut të punës për programin që po vlerësohet. <b>Për sa më lart, në kushtet e mungesës së një studimi të mirëfilltë të tregut të punës që lidhet drejtpërdrejt me programin e studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, GVJ rekomandon që departamenti të kryejë një studim tregu për këtë program studimi.</b></p> <p>Duke qenë se ka mospërputhje në të dhënat e përcjella nga IAL, GVJ paraqet në vijim të dhënat sipas të dy evidencave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sipas të dhënave në evidencën <b>4.8_ Të dhëna për regjistrimin, ecurinë (tabela 23)</b>, në periudhën 2019-2021 (të dhënat janë paraqitur për të gjithë periudhën dhe jo të specifikuar sipas viteve), prej 76 të diplomuarve në total për këtë periudhë, 56 prej tyre janë të punësuar në përputhje me diplomën (73.7%) dhe 20 janë të punësuar jo në përputhje me diplomën (26.3);</li> <li>- Sipas të dhënave në evidencën <b>4.14_ Të dhëna për punësimin real të studentëve (tabelat 4-6)</b>, në vitin 2019, nga 26 studentë të diplomuar, paraqiten 24 studentë të punësuar ose 92.3% (2 studentë</li> </ul>




	<p>janë larguar jashtë), nga të cilët 9 prej tyre janë të punësuar brenda profilit; në vitin 2020, nga 18 studentë të diplomuar, paraqiten 17 të punësuar ose 94.4% (1 student i larguar jashtë) dhe 11 studentë të punësuar brenda profilit; në vitin 2021, nga 27 studentë të diplomuar, paraqiten 23 studentë të punësuar ose 85.2%, nga të cilët 11 janë të punësuar brenda profilit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar syllabuseve të lëndëve (<b>Evidencë 4.3_Programet e lëndëve</b>), takimeve me pedagogë të angazhuar në këtë program studimi, takimeve me studentë (<b>Vizita në Institucion, takimi me pedagogët dhe studentët e programit</b>) si dhe statistikave të punësimit (<b>Evidencë 4.8_Të dhëna për regjistrimin, ecurinë (tabela 23); Evidencë 4.14_të dhëna për punësimin real të studentëve</b>) GVJ është i mendimit se objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që, në një masë të konsiderueshme lehtëson dhe punësimin e tyre. Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip” synon së pari të edukojë dhe të përgatisë individë të kualifikuar për të shërbyer dhe për të përmbushur nevojat e tregut të punës në mënyrë optimale. Objektivat e këtij programi studimi “....synojnë të përgatisin studiues të fushës së etikës, ekspertë të çështjeve sociale e morale bashkëkohore, të aftë për të analizuar dhe vlerësuar ato nga perspektiva ndërdisiplinore, specialistë të administratës publike me kulturë të gjerë filozofike....” (<b>Cit. Korniza konceptuale e programit të studimit Evidencë 4.1</b>). Duke pasur parasysh përpjekjet e mëdha për integrimin e Shqipërisë në strukturat perëndimore, kërkesat e tregut të punës për individë të kualifikuar konsiderohen të larta. Po ashtu, referuar të dhënave (pavarësisht disa mospërputhjeve në to) (<b>Evidencë 4.8_Të dhëna për regjistrimin, ecurinë (tabela 23); Evidencë 4.14_Të dhëna për punësimin real të studentëve</b>), por edhe nga diskutimet me GVB-në, me Përgjegjësën e Departamentit të Filozofisë, studentë alumni dhe studentë aktualë, u referua se një numër i konsiderueshëm i studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi janë punësuar pas diplomimit në profilin që kanë përfunduar studimet.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përfaqësohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip” është hartuar duke u bazuar në programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, por duke e përshtatur për një kohëzgjatje 2 vjeçare (<b>Evidencë RVB, fq. 10; Takime në institucion me anëtarët e GVB, Koordinatorin e programit</b>). Përmbajtja e këtij programi studimi, e organizuar në kategori (A-E) si dhe raporti midis komponentëve teorik dhe atyre praktik, garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, për studentët që përfundojnë një program studimi të ciklit të dytë, në fushën e etikës dhe lidërsip-it (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e</b></p>



	<p><b>Programit të Studimit; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë 4.2_Plani mësimor i programit të studimit).</b> Kombinimi i njohurive teorike të përfituara në lëndë të tilla si: Liria dhe të Drejtat e Njeriut, Morali dhe Politika, E Drejta dhe Shoqëria, Teori Etike Bashkëkohore, Etika në Administratë dhe Biznes, Teoritë e Përfaqësimit, Menaxhimi i Konfliktëve, kombinuar me lëndët me zgjedhje të tilla si: E Drejta Administrative, Teori Komunikimi dhe Lidhshmëria dhe Përkatësi Gjinore, me një literaturë kjo edhe në gjuhë të huaj, kanë si qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve në një IAL vendase ose të huaj, por njohuritë e përshtatshme teorike dhe praktike lehtësojnë njëherazi edhe punësimin e studentëve në të ardhmen. Pajisja e të diplomuarve me suplementin e diplomës <b>(Evidencë 3.10_Modeli i suplementit të diplomës)</b> lehtëson lexueshmërinë e diplomës dhe i hap rrugë mundësisë për studime të ngjashme apo dhe më të avancuara në institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidhshmëria” i cili realizohet në Departamentin e Filozofisë, zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, përcaktuar si program studimi i ciklit të dytë dhe vlerësuar me kredite (ECTS) sipas sistemit evropian të vlerësimit me kredite (RVB, fq. 10, 11; <b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë 4.2_Plani mësimor i programit të studimit).</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidhshmëria” përfshin kryerjen e praktikës si një element mjaft i rëndësishëm i formimit <b>(Evidenca 4.2_Plani mësimor i programit të studimit).</b> Suksesi i realizimit të saj bazohet në një numër marrëveshjesh të lidhura me aktorë të ndryshëm që operojnë në fushën e filozofisë dhe etikës në institucione dhe lidhshmëritë. <b>(Evidencë 3.17_Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikës profesionale për programin e studimit)</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit e</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidhshmëria” ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Në strategjinë e tij, Departamenti i Filozofisë, ka si prioritet të tij ndërkombëtarizimin <b>(Evidenca 3.2, pika 4_Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Filozofisë; Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit pika 7.5).</b> GVJ është i mendimit se argumentimi i dhënë nga IAL në RVB, në Standardin 1.3, kriteri 7, se përgatitja e syllabuseve dhe literaturës në gjuhë të huaj, mundëson prurjet përtej vendit, nuk mund të jetë elementi i vetëm për ofrimin e ndjekjes së studimeve nga studentët të huaj.</p>



institucionit.									
<b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze.	Nga konsultimi i dokumentacionit në Departamentin e Filozofisë, konstatoam se krahas atyre në shqip, njësia bazë ofronte në gjuhë të huaj dokumentat: Supelementi i diplomës ( <b>Evidencë 3.10</b> ); Plani mësimor ( <b>Evidencë 5.2</b> ); Syllabuset e lëndëve ( <b>Evidencë 5.3</b> ); Korniza konceptuale e programit të studimit ( <b>Evidencë 4.1</b> ); Rregullorja e programit të studimit ( <b>Evidencë 3.6</b> ).								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> <td></td> </tr> </table>			<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>			<b>X</b>	
		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
		<b>X</b>							

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Sipas RVB-së dhe të dhënave tabelore, pjesë e DVV, në programin e studimit Master i Shkencave “Etika në institucione dhe lidhshëm”</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në vitin akademik <b>2018-2019: 8 PAE</b>, me kualifikimin 1 Prof. As., 6 Dr., dhe 1 Msc., dhe <b>10 PAK</b>, me kualifikimin 2 Dr. dhe 8 Msc.;</li> <li>Në vitin akademik <b>2019-2020: 7 PAE</b>, me kualifikimin 1 Prof. As., 5 Dr., dhe 1 Msc., dhe <b>11 PAK</b>, me kualifikimin 3 Dr. dhe 8 Msc.;</li> <li>Në vitin akademik <b>2020-2021: 7 PAE</b>, me kualifikimin 1 Prof. As., 5 Dr., dhe 1 Msc., dhe <b>15 PAK</b>, me kualifikimin 5 Dr., dhe 10 Msc.;</li> <li>Në vitin akademik <b>2021-2022: 6 PAE</b>, me kualifikimin 1 Prof. As., dhe 5 Dr., dhe <b>13 PAK</b>, me kualifikimin 1 Prof., 4 Dr., dhe 8 Msc.</li> </ul> <p><b>(Evidencë 4.6_Doc shtesë pas vizitave në institucion_Të dhëna tabelore për personelin akademik; Evidencë 4.16_CV e personelit akademik dhe ndihmës-akademik)</b></p> <p>Sikurse është analizuar me detaje edhe në standardin II.5, kriteri 1 dhe 2, konstatohet se në këtë program studimi është angazhuar personel akademik me Msc., si dhe jo të titullarët e lëndëve i përjashton kategorisë “Profesor”, duke mos qenë kështu në përputhje me parashikimet e ligjit 80/2015. Gjithashtu, ngarkesa mësimore e programit nuk mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv. <i>GVJ rekomandon që pavarësisht kapaciteve akademike dhe administrative që ka, Institucioni duhet të marrë masa për të rritur në një përqindje më të</i></p>



	<i>madhe stafin me kohë të plotë dhe të kualifikuar (grada dhe tituj) për këtë program studimi, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</i>		
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidership” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë, përgjegjëse për këtë program. Ky program studimi është hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe është i regjistruar si program i Ciklit të II-të Master i Shkencave, niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe përfshihet në fushën e filozofisë, etikës në institucione dhe lidershipit ( <b>Evidencë 1.2, Neni 92_Statuti UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS; Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit</b> ).		
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Departamenti i Filozofisë e orienton punën kërkimore shkencore në përputhje me programet që ofron. GVJ konstaton lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidership”, një përputhje të plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike me fushën akademike e kërkimore të Departamentit, përgjegjës për programin e studimit ( <b>Evidencë 3.2_Strategjia e zhvillimit të departamentit “Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit master i shkencave “Etika në institucione dhe lidership”</b> ).		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>


### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e	Administrimi i programit të studimit Master i Shkencave “Etika në institucione dhe lidership” realizohet nga Departamenti i Filozofisë, mbështetur në rregulloren e programit të studimit ( <b>Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit</b> ), rregulloren e FSHS ( <b>Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS</b> ) rregulloren e departamentit ( <b>Evidencë 3.3_Rregullore e DF</b> ) si dhe gjithë aktet ligjore e nënligjore



<p>personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>në fuqi. Angazhimi i personelit akademik nga fakultete të tjera të UT si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësive respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre <b>(Evidencë 2.22 _Udhëzim për dosjen e pedagogut).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të programit të studimit institucioni ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional, ku lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe projekteve të cilat impaktojnë edhe këtë program studimi, zhvillohet në kuadër institucional. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh dhe organizata bashkëpunuese homologe vendase si Bashkia Tiranë, Njësitë Bashkiake, Kuvendi i Shqipërisë, Agjencia e Rinisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra Master Thinker, Departamenti i Etnologjisë, ISSH, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, etj. <b>(Evidencë 3.19_Raport analitik për marrëveshjet e bashkëpunimit që lidhen me programin e studimit; Evidencë 3.21_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidencë 4.12_Lista e projekteve që kanë patur ndikim tek programi i studimit).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>UT ka marrëdhënie zyrtare me Institucione publike dhe ato private, për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës mësimore <b>(Evidencë 3.17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për zhvillimin e praktikës profesionale).</b> Zhvillimi i praktikës kryhet duke ju referuar rregullores përkatëse dhe përfundon me një raport të praktikës profesionale. <b>(Evidencë 3.6, Neni 10, Rregullore e programit të studimit; Evidencë 4.4 Paketa e praktikës për programin e studimit master i shkencave “Etika në institucione dhe lidhshmëri”).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka marrëdhënie zyrtare me komunitetin e biznesit e tregun e punës për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale. Departamenti i Filozofisë ka hartuar disa marrëveshje zyrtare për realizimin e programeve të studimit dhe praktikave mësimore e profesionale, çka ndihmon në përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentëve të këtij programi studimi. <i>Megjithatë, GVJ i sugjeron institucionit, të marrë masa për të shtuar dhe rifreskuar marrëveshjet ekzistuese, sidomos bashkëpunimet me institucione akademike jashtë vendit.</i> <b>(Evidencë 3.21_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni, falë nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe apo institute kërkimore, mundëson aktivitete ekstra-kurrikulare të studentëve të programit. Politikat që ndjek institucioni për bashkëpunim, mundësojnë realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare duke kontribuar në përmirësimin e programit të studimit, dhe bashkëpunime të qenësishme për partneritet në projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, praktikë e dobishme për</p>




	fuqizimin e komponentit kërkimor. Në nivel njësie bazë, gjatë vitit 2020-2021 janë realizuar disa bashkëpunime si: Instituti Konfuci, Biblioteka Kombëtare, Avokati i Popullit, Dhoma ekonomike e gruas, Shoqata për Trashëgimi dhe Edukim, Master Thinker Institute., etj. <b>(Evidencë 2.23_Politikat për bashkëpunim dhe partneritet; Evidencë 3.21_Tabela përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit; Evidencë 4.7_Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik)</b>		
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Referuar Raportit Vjetor që njësia bazë harton në fund të viti akademik <b>(Evidencë 3.18_Raport Vjetor i DF)</b> , por edhe nga diskutimet me staf dhe studentë të këtij programi studimi, rezulton se Departamenti i Filozofisë ka hartuar një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit dhe praktikave profesionale si edhe përgatitja e tezës perfundimtare (diplomim) <b>(Evidencë 3.19_Raporti analitik i përfitimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit) 2020-2021)</b> , ku gjithashtu pohohet se për arsye të një marrëdhënie të ngushtë me punëdhënësit, zhvillimi i praktikave ka qenë i suksesshëm.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi I.6


**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Gjatë shqyrtimit të DVV dhe takimeve në institucion me GVB-në, Përgjegjësin e Departamentit të Filozofisë si dhe Koordinatorin e programit, rezulton se Fakulteti i Shkencave Sociale, e konkretisht Departamenti i Filozofisë harton politika të lidhura me fushën e kërkimit shkencor, si një komponent organik, të cilat janë konkrete dhe të fokusuara, e që përfshijnë pedagogë e studentë në të gjitha nivelet e kërkimit shkencor. Gjatë veprimtarisë kërkimore shkencore, departamenti angazhohet për nxitjen dhe promovimin, zhvillimin dhe aftësimin e personelit akademik, studiuesve të rinj si dhe studentëve të këtij programi studimi, nëpërmjet pjesëmarrjeve në konferenca, botimeve në revista shkencore, aktivizimin dhe mbështetjen e studentëve në punimin e mikrotezës, etj. <b>(Evidencë 4.11_Të dhënat për aktivitetet dhe kualifikimet shkencore të stafit akademik; Evidencë 4.7_Veprimtaritë kërkimore ne nivel programi).</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngrre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit	Njësia bazë është njësia që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, i cili duhet në mënyrë periodike, të kryejë analiza të shumë elementëve, pjesë të cilësisë së një programi studimi, ku



shkencor.	produkti kërkimor shkencor matet nëpërmjet treguesve cilësorë dhe sasiorë, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. <b>(Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit; Evidencë 3.2_Strategjia e DF; Evidencë 3.18_Rraporti vjetor; Evidencë 4.7_Veprimtaritë kërkimore ne nivel programi)</b>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Në lidhje me promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit, e lidhur kjo me botimet me karakter shkencor të stafit akademik, nga dokumentacioni i venë në dispozicion, GVJ konstatoi një pjesëmarrje të rregullt me artikuj, si dhe botime ne revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, të tilla numërohen rreth 40, aktivitete shkencore konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, rreth 18 leksione të hapura me lektorë të ftuar si dhe mobilitet i stafit akademik dhe studentë ku në vitin 2020 një studente e këtij programi konkuroi dhe fitoi në programet ERASMUS+ <b>(Evidencë 1.16_Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor; Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit; Evidencë 4.11_Të dhënat për aktivitetet dhe kualifikimet shkencore të stafit akademik; Evidencë 4.7_Veprimtaritë kërkimore ne nivel programi).</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Institucioni, përveç mbështetjes financiare, ndjek politika për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në veprimtaritë individuale të stafit akademik në fushën e kërkimit, duke ndëshkuar çdo plagjiturë sikurse e parashikon rregullorja e Institucionit. <b>(Evidencë 1.5_Kodi i etikës; Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit)</b>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Institucioni, gjatë gjithë veprimtarisë së tij kërkimore e shkencore, një kujdes të veçantë i kushton studentëve për të nxitur zhvillimin e aftësive të tyre kërkimore shkencore, për të përmirësuar dhe promovuar modelet e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca shkencore etj. Gjatë diskutimeve me studentët e programit të studimit dhe përgjegjësen e departamentit, sikurse dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, GVJ konstaton se institucioni inkurajon dhe motivon angazhimin e studentëve dhe studiuesve të rinj në iniciativa vetjake, në projekte dhe aktivitete kërkimore (detyrat e kursit/projektet). Përfshirja e studentëve në konferencat shkencore të organizuara nga Departamenti janë tregues të përmbushjes së këtij kriteri. Ndër aktivitetet kryesore në të cilat janë angazhuar studentët, mund të përmendim: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Orët e kinemasë dhe imazhi fotografik;</li> <li>• Konferenca shkencore ndërkombëtare “Elitat me mendim dhe platforma idesh, jeta menodnjëse dhe debati për projektimin e shqiptarit dhe Shqipërisë në prosperitet”, ku referuan 6 studentë;</li> <li>• Workshopi ‘Universiteti dhe filozofia përballë modeleve të zhvillimit të sotëm botëror’, ku kanë referuar 3 studentë.</li> </ul> <b>(Evidencë 4.7_Veprimtaritë kërkimore ne nivel programi, Pika VIII. Aktivizimi i studentëve në veprimtari shkencore; Evidencë</b>




	<b>4.19_Dosje e leksioneve dhe aktiviteteve të Departamentit).</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>


## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidërsip” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>), në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM Nr. 41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar). Programi i studimit ka në total 14 lëndë të detyrueshme, 2 lëndë me zgjedhje, praktikën dhe detyrimin përmbyllës (punim diplome), të ndara në kategori A-E, të vlerësuara me kredite dhe të shpërndara në mënyrë të balancuar në 2 vite akademik dhe 4 semestra. Pësha që zënë lëndët sipas kategorive, krahasuar me parashikimet ligjore në fuqi, është si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kategoria A, ka një ngarkesë prej 12 ECTS (10%) – standardi 5-10%;</li> <li>• Kategoria B, ka një ngarkesë prej 62 ECTS (51.6%) – standardi 50-60%;</li> <li>• Kategoria C, ka një ngarkesë prej 16 ECTS (13.3%) – standardi 12-20%;</li> <li>• Kategoria D, ka një ngarkesë prej 8 ECTS (6.7%) – standardi 10%;</li> <li>• Kategoria E, ka një ngarkesë prej 18 ECTS (15%) – standardi 10-15%.</li> </ul> <p><i>Sikurse vihet re edhe nga krahasimi midis ngarkesës së secilës kategori, në raport me standardin, në të gjitha kategoritë përveç kategorisë D, pësha që zënë lëndët është në përputhje me parashikimet ligjore. Duke qenë se ngarkesa e kategorisë D ka një</i></p>




	<i>diferencë prej 3.3 %, rekomandohet që të vlerësohet mundësia që në këtë kategori të shtohet një lëndë ose të rritet ngarkesa e praktikës profesionale.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, ofruar nga Departamenti i Filozofisë, synon të përgatisë studiues të fushës së etikës, ekspertë të çështjeve sociale e morale bashkëkohore, të aftë për t’i analizuar dhe vlerësuar ato nga perspektiva ndërdisiplinore, specialistë të administratës publike, këshilltarë, drejtues projektesh, etj. Nëpërmjet këtij programi, synohet që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të marrin informacion të ri bashkëkohor në fushën e etikës institucionale e lidërsip-it e të pajisen me dije e koncepte të thelluara në fushat e veçanta të lirisë dhe të drejtave të njeriut, menaxhimit të konflikteve, komunikimit institucional, etikës publike e administrative, bioetikës dhe etikës së mjedisit, etj.;</li> <li>• Të realizojnë një njohje të thelluar të marrëdhënieve midis institucioneve ekonomike, politike dhe kulturore, proceseve vendim marrëse e implikimeve etike të tyre;</li> <li>• Të kultivojnë aftësitë e nevojshme për të analizuar çështje aktuale etike, duke zhvilluar mendimin kritik e aftësinë për zgjidhje të mundshme të konflikteve e implikimeve të tyre etike;</li> <li>• Të kuptojnë në thellësi marrëdhëniet e ndërveprimit midis praktikës morale e dilemave morale aktuale me teorinë etike (<b>Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit, pika 3 Objektivat e Programit të studimit dhe rezultatet e pritshme</b>).</li> </ul> <p>Studentët që diplomohen në këtë program studimi mund të punësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në administratën publike, institucione vendore e private;</li> <li>• Në Organizata Jo Fitimprurëse;</li> <li>• Në fushën e lidërsip-it dhe këshillimit;</li> <li>• Burime njerëzore;</li> <li>• Në shërbimet private që mbulojnë kompani e shoqëri të ndryshme (<b>Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit, pika 10</b>).</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<p>Programi i studimit ofron njohuri të përparura në fushën e etikës, ku përfshihen si aspektet teorike ashtu edhe ato të parimeve akademike të fushës (<b>Evidencë shitesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>). Si struktura dhe përmbajtja e kurrikulës, ashtu edhe syllabuset e lëndëve (<b>Evidencë shitesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b>), garantojnë që programi i studimit MSc. në “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, ofron njohuri të përparura në fushën e studimit. Gjithashtu, ky program mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive që pritet të kenë përfituar në kurset teorike. Në përfundim të këtij programi studimi, synohet që studentët të marrin informacion</p>



	bashkëkohor në fushën e etikës institucionale dhe lidërsip, të realizojnë një njohje të thelluar të marrëdhënieve midis institucioneve ekonomike, politike dhe kulturore, të kultivojnë aftësitë e nevojshme për të analizuar çështjet aktuale etike, duke zhvilluar mendimin kritik, sikurse dhe të kuptojnë në thellësi marrëdhëniet e ndërveprimin midis praktikës morale e dilemave morale aktuale me teoritë etike ( <b>Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit, pika 3 Objektivat e Programit të studimit dhe rezultatet e pritshme</b> ).
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi ofron mundësinë e zhvillimit të aftësive dhe kompetencave në fushën e etikës, të përshtatshme për një program të ciklit të dytë të studimeve. Ndërthurja e komponentëve teorik me ato praktik, mundëson pajisjen e studentëve me aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e etikës ( <b>Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b> ). Programi ndërthur njohuritë e përgjithshme, të përcaktuara në Kategorinë A, me njohuritë specifike të lidhura me fushën e studimit, të përcaktuara në Kategorinë B ( <b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b> ). Në Kategorinë A përfshihen lëndët Morali dhe Politika, sikurse dhe Teoritë e Sferës Publike, ndërsa ndër lëndët kryesore në kategorinë B, përmendim: Liria dhe të Drejtat e Njeriut, E Drejta dhe Shoqëria, Teori Etike Bashkëkohore, Etika në Administratë dhe Biznes, Komunikim Institucional, Lidërsip-i dhe Standardet, etj. Kombinimi i njohurive të përfituara nga këto lëndë, mundëson kompetencat e nevojshme për të identifikuar, analizuar dhe dhënë rekomandime, lidhur me çështjet etike dhe të lidërsip-it.
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidërsip” është i organizuar sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar). Programi është i organizuar sipas Kategorive A-E, me përmbajtje sipas parashikimeve ligjore për natyrën e lëndëve në secilën kategori, sikurse dhe praktikën dhe detyrimin përmbyllës (punim diplome), me kohëzgjatje 2 vite akademike, 4 semestra, dhe me një ngarkesë prej 120 ECTS (me një shpërndarje të balancuar prej 60 ECTS në secilin vit akademik) ( <b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b> ).
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke	Programi i studimit i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke i grupuar lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse të shprehur në kreditë ECTS ( <b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b> ). Programi është i organizuar në dy




<p>grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>vite akademike (120 ECTS), 4 semestra. Kategoria A ka një ngarkesë prej 12 ECTS (10%) dhe ka të grupuara lëndë për kulturë të përgjithshme. Në kategorinë B, e cila ka një ngarkesë prej 62 ECTS (51.6%), janë të grupuara lëndët për përgatitjen për disiplinën e etikës dhe lidërsip-it. Kategoria C, me një ngarkesë prej 20 ECTS (16.6%), grupon lëndë ndërdisiplinore dhe lëndë me zgjedhje. Kategoria D, me një ngarkesë prej 8 ECTS (6.6%), përfshin komponentin e praktikës. Kategoria E përfshin punimin e diplomës, dhe ka një ngarkesë prej 18 ECTS (15%) (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>).</p> <p>Përsa i përket veprimtarive formuese të Kategorisë A, VKM nr. 41 përcakton se Kategoria A përmban lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme. <b>Nga analiza e planit mësimor, konstatohet mungesa e lëndëve për përgatitje metodologjike (Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit). Duke qenë se sipas VKM Nr. 41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, kategoria A përfshin lëndë për përgatitjen metodologjike dhe kulturë të përgjithshme dhe duke marrë në konsideratë se programi në proces vlerësimi është program i ciklit të dytë, Master i Shkencave, i cili përmbyllet me punim diplome dhe i jep mundësinë studentëve të diplomuar për të vijuar në ciklin e tretë të studimeve, GVJ rekomandon që njëra nga lëndët ekzistuese në Kategorinë A të zëvendësohet me një lëndë për përgatitjen metodologjike (Metoda Kërkimi).</b></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të programit të studimit, Kategoria E përfshin punimin e diplomës, dhe ka një ngarkesë prej 18 ECTS (15%) (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>).</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

**Standardi II.2**


**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti, në bashkëpunim edhe me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), kryejnë vlerësimin e brendshëm periodik për rezultatet dhe nivelin cilësor të aktiviteteve formuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore (<b>Evidencë 1.2_Statuti UT, Neni 41, Neni 138-141; Evidencë 1.6_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Evidencë</b></p>



	<p><b>1.11_Manuali i cilësisë; Evidencë 2.12_Vendim i FSHS për ngritjen e NJSC; Evidencë 2.13_Përshkrim i veprimtarisë së NJSC; Evidencë 2.17_Të dhëna tabelore për NJSBC).</b> Lidhur me procesin e vlerësimit të jashtëm, institucioni i është nënshtruar procesit periodik të vlerësimit të jashtëm, akreditimit (<b>Evidencë 1.18_Certifikatë Akreditimi</b>), ndërsa programi i studimit po i nënshtrohet për herë të parë këtij procesi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Filozofisë, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Sociale, i cili ka në përbërjen e tij edhe 4 Departamente të tjerë, respektivisht Departamenti i Shkencave Politike, Departamenti i Pedagogji Psikologjisë, Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale dhe Departamenti i Sociologjisë. Struktura akademike mbështetet dhe nga struktura administrative, ndër njësitë kryesore të së cilës janë Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Dega e Shërbimeve për Studentët dhe Projektet, Dega Mësimore, Biblioteka, Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e IT (<b>Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS; Evidencë 2.5_Struktura organizative e FSHS; Evidencë 3.3_Rregullore e Departamentit</b>). Njësia bazë përgjegjëse përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti i Filozofisë përbëhet nga së paku 7 anëtarë staf akademik me kohë të plotë, ku të paktën 3 janë më tituj/grada (<b>Evidencë 4.6 gjatë vizitës_Personeli akademik</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Numri dhe shkalla e kualifikimit të personelit akademik janë konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi (<b>Evidencë 4.6 gjatë vizitës_Personeli akademik; Evidencë 4.16_CV e personelit akademik dhe ndihmës-akademik</b>). Përbërja e njësisë bazë në tre vitet e fundit akademike paraqitet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Viti akademik <b>2021-2022: 8 PAE</b>, prej të cilëve 1 Prof. Dr., 2 Prof. As dhe 5 Dr., <b>30 PAK</b>, prej të cilëve 1 Prof. Dr., 8 Dr., dhe 21 Msc., dhe 1 personel ndihmës akademik;</li> <li>- Viti akademik <b>2020-2021: 8 PAE</b>, prej të cilëve 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., dhe 6 Dr., <b>25 PAK</b>, prej të cilëve 7 Dr. dhe 18 Msc., dhe 1 personel ndihmës akademik;</li> <li>- Viti akademik <b>2019-2020: 8 PAE</b>, prej të cilëve 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., dhe 6 Dr., <b>31 PAK</b>, prej të cilëve 8 Dr., dhe 23 Msc., dhe 1 personel ndihmës akademik (<b>Evidencë 4.6 gjatë vizitës_Personeli akademik</b>).</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Filozofisë, një nga pesë njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Sociale. Organizimi dhe struktura akademike e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, është konform parashikimeve ligjore në fuqi, dhe funksionojnë në bazë të akteve të brendshme rregullatore (<b>Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS; Evidencë</b></p>







	<b>2.5_Struktura organizative e FSHS; Evidencë 3.3_Rregullore e Departamentit; Evidencë 4.6 gjatë vizitës_Personeli akademik).</b>		
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Njësia bazë ka në përbërjen e saj një personel akademik ndihmës, i cili mbështet Departamentin në realizimin e proceseve akademike fuqi ( <b>Evidencë 4.6 gjatë vizitës_Personeli akademik</b> ). Për realizimin e praktikave mësimore, Departamenti angazhon personel akademik efektiv.		
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti ka caktuar një koordinator për programin Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidërsip” ( <b>Evidencë 3.11_Vendim për caktimin e Koordinatorit të Programit të Studimit</b> ). Koordinator i programit të studimit mbështet planifikimin, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit, për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivave të programit. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të tij janë të parashikuara në aktet e brendshme rregullatore ( <b>Evidencë 3.12_Përshkrimi i detyrave të Koordinatorit të Programit të Studimit</b> ). Ndër detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Koordinatorit të Programit, janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koordinon punën për hartimin dhe përmirësimin e rregullores së programit të studimit, përgatitjen e strategjisë së zhvillimit të programit, përgatitjen e planit mësimor, paketës së praktikës dhe paketës së punimit të diplomës;</li> <li>• Mban dosjen e dokumentacionit bazë të programit të studimit (planit mësimor, programet mësimore lëndore, rregulloren e programit të studimit, të dhënat për personelin akademik dhe studentët, marrëveshjet e bashkëpunimit, etj.);</li> <li>• Monitoron zbatimin e planit mësimor;</li> <li>• Koordinon organizimin e praktikës;</li> <li>• Në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, merr pjesë në organizimin e veprimtarive të informimit për maturantët;</li> <li>• Ndjek procedurat e regjistrimit dhe transferimit të studentëve;</li> <li>• I raporton drejtuesit të njësisë bazë për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi.</li> </ul>		
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike tek drejtuesi i departamentit lidhur me çështjet të cilat janë objekt i detyrave dhe përgjegjësi që ai ka, bazuar në aktet e brendshme rregullatore ( <b>Evidencë 3.11_Vendim për caktimin e Koordinatorit të Programit të Studimit; Evidencë 3.12_Përshkrimi i detyrave të Koordinatorit të Programit të Studimit</b> ).		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X




<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, konfirmuar edhe gjatë vizitës dhe takimeve të zhvilluara në institucion (<b>Evidencë Takimet në institucion me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Drejtuesin e Departamentit të Filozofisë</b>), konstatohet se njësia përgjegjëse disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidership”. Drejtuesi i Departamentit, në bashkëpunim edhe me Dekanin dhe Koordinatorin e Programit, grumbullojnë dhe analizojnë informacionin e plotë mbi programin, i cili u shërben për të marrë edhe masa në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit (<b>Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS; Evidencë 3.3_Rregullore e Departamentit; Evidencë 2.18_Analizë vjetore e punës së FSHS; Evidencë 3.2_Strategjia e Zhvillimit të Departamentit; Evidencë 3.5_Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit; Evidencë 3.18_Raport për veprimtarinë e programit të studimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidership” është i organizuar në lëndë/module, praktikë dhe aktivitete formuese, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar). Programi i studimit ka në total 14 lëndë të detyrueshme, 2 lëndë me zgjedhje, praktikën dhe detyrimin përmbyllës (punim diplome), të ndara në kategori A-E, të vlerësuara me kreditë dhe të shpërndara në mënyrë të balancuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra (<b>Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Të gjitha lëndët/modulet, sikurse dhe detyrimet e tjera të programit të studimit, të tilla si praktika dhe diploma, janë të vlerësuara me kredite ECTS, të ndara në 2 vite akademike dhe 4 semestra (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>). Shpërndarja e ngarkesës mësimore ndër vite është e balancuar, sikurse dhe strukturimi i lëndëve, duke nisur me lëndë të karakterit të përgjithshëm në semestrin e parë, e deri tek praktika dhe diploma në semestrin e fundit, vlerësohen si të përshtatshme.</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i detajuar, është pjesë integrale e Rregullores së Programit (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit</b>). Në planin mësimor – përfshihet informacioni i nevojshëm për lëndët/modulet, viti dhe semestri kur ofrohet lënda/moduli, ngarkesa mësimore, leksionet, seminarët, ushtrimet, orët në auditor dhe jashtë tij. Mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohet në Rregulloren e Programit, sikurse dhe syllabusët e lëndëve (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b>). Ngarkesa totale e programit të studimit është 120 ECTS (3000 orë në total, prej të cilave 1035 orë në auditor/ 1965 orë studim individual dhe praktikë), me një shpërndarje prej 60 ECTS/1500 orë, në secilin vit akademik. Në vitin e I-rë, programi ka të parashikuar 630 orë në auditor dhe 870 orë studim individual, në vitin e II-të ky raport është 405 orë në auditor/1095 orë studim individual dhe praktikë. Në planin mësimor detajohen orët për leksionet/ seminarët/ ushtrimet/ laboratorët/detyrat, si në auditor ashtu edhe orët e studimit individual. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar;</li> <li>• me detyra kursi, projekte, poster;</li> <li>• i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.</li> </ul> <p>Në syllabusët e lëndëve janë të përcaktuara format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe pesha specifike në përqindje e secilit prej komponentëve të vlerësimit. Format e kontrollit të vazhdueshëm, të cilat kanë shpërndarje të ndryshme në lëndë të ndryshme, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• pjesëmarrja aktive në seminare – 10-20%;</li> <li>• detyrë kursi/temë studimore – 20%;</li> <li>• provimi ndërmjetëm – 0-20%;</li> <li>• provimi përfundimtar – 60%.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve është i përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit</b>). Kriteret e përgjithshme për pranimin në këtë program studimi janë: mbrojtja e gjuhës së huaj (niveli B1) dhe përfundimi i ciklit të parë. Si kriter preferencial është vendosur përfundimi i studimeve të mëparshme në këtë departament. Kriter specifik është zotërimi i diplomës së ciklit të parë në Filozofi, Sociologji, Arte, Shkenca Humane ose Shkenca të Natyrës (<b>Evidencë 3.13_Vendim për miratimin e kuotave të pranimit; Evidencë 3.14_Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet</p>	<p>Programi i studimit (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit</b>), plani mësimor (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>), sikurse dhe programet lëndore (<b>Evidencë</b></p>




<p>lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p><b>shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b>), vlerësohet se janë të plota dhe përmbajnë informacionet e nevojshme për të gjithë komponentët mësimor. Në syllabuse, të cilat i vihen në dispozicion studentëve që në nisje të semestrit përkatës, jepen të dhëna të plota mbi lëndën, nga përmbajtja tek format e vlerësimit dhe literatura e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar. Programet e lëndëve kanë të detajuar titullin e lëndës dhe titullarin, ngarkesën të shprehur në kredite ECTS, numrin e leksioneve/seminareve, vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, përmbledhjen e lëndës dhe rezultatet e të nxënit, temat sipas javëve, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, politikën e frekuentimit sikurse dhe format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe peshën e tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Përmirësimi dhe përditësimi i programit të studimit është një proces i cili evidentohet si nga dokumentacioni i administruar (<b>Evidencë 2.16_Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të programeve të studimit; Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Evidencë 3.15_Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës</b>), ashtu edhe gjatë diskutimeve në takimet e zhvilluar në institucion (<b>Evidencë_Takimet në institucion me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale, Drejtuesin e Departamentit të Filozofisë, përfaqësuesit e Zyrës së Kurrikulave sikurse dhe me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi</b>). Këto ndryshime lidhen si me përditësimin e syllabuseve, ashtu edhe me përditësimin e programit të studimit në tërësi. Procesi nis me diskutimet në Departament, ku diskutohet për propozimet për ndryshimin e programeve të studimit. Propozimi i Departamentit i përcillet Dekanit të Fakultetit, shoqëruar me një relacion shpjegues në lidhje me ndryshimet e planeve mësimore. Pas miratimit të propozimit nga ana e Dekanit, procesi vijon me njësinë përgjegjëse për kurrikulat përpara se të përcillen në Senatin Akademik për miratimin përfundimtar. GVJ konstaton se procedura e ndjekur është konform parashikimeve ligjore në fuqi, bazuar dhe në aktet e brendshme rregullatore.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

**Standardi II.4**



**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe</p>




<p>të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Lidership” është i organizuar në 120 ECTS, 2 vite akademike, 4 semestra, me një shpërndarje të balancuar të ngarkesës të shprehur në kreditë ECTS (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>), në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Duke iu referuar kornizës ligjore, një kredit (ECTS) korrespondon me 25 orë pune të një studenti dhe sasia mesatare e punës së përfunduar gjatë një viti të studimeve për një student është 60 (gjashtëdhjetë) ECTS ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë të orarit të punës së studentëve, i cili përfshin orë në auditor dhe orët e punës së pavarur.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidership” vlerësohet si i përshtatshëm në funksion të përmbajtjes, objektivave formuese por edhe mundësive të punësimit apo vijimit të studimeve në ciklet pasardhëse. Kombinimi i komponentëve teorik me ato praktik, vlerësohet i përshtatshëm, duke qenë se në semestrat e parë studentët pajisen me njohuri të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të disiplinës përkatëse, për të vijuar në vitin e dytë me praktikën dhe punimin e diplomës (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>). Shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, integruese dhe plotësuese, ndihmon studentët të fitojnë njohuri, të përmirësojnë aftësitë dhe të rrisin mundësitë e punësimit të tyre si ekspertë në administratën publike, institucione vendore e private, në Organizata Jo Fitimprurëse, në fushën e lidërsip-it dhe këshillimit, burime njerëzore apo në shërbimet private që mbulojnë kompani e shoqëri të ndryshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Vlerësohet se struktura, organizmi dhe përmbajtja e programit të studimit (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>), mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor: aftësi për të identifikuar dhe analizuar me argumente etike problematika të fushës, për të dhënë ekspertizë për zgjidhjen e konflikteve me natyrë etike, për të formuluar rekomandime për politika që lidhen me çështje morale, për të kuptuar implikimet e karakterit ligjor e politik të çështjeve e problematikave etike, etj. (<b>Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit, pika 4 Rezultatet e pritshme</b>) duke bërë të mundur në këtë mënyrë që në përfundim të studimeve studentët të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të marrin informacion të ri bashkëkohor në fushën e etikës institucionale e lidërsip-it e të pajisen me dije e koncepte të thelluara në fushat e veçanta të lirisë dhe të drejtave të njeriut, menaxhimit të konflikteve, komunikimit institucional, etikës publike e administrative, bioetikës dhe etikës së mjedisit, etj.;</li> <li>• Të realizojnë një njohje të thelluar të marrëdhënive midis institucioneve ekonomike, politike dhe kulturore, proceseve vendim marrëse e implikimeve etike të tyre;</li> </ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kultivojnë aftësitë e nevojshme për të analizuar çështje aktuale etike, duke zhvilluar mendimin kritik e aftësinë për zgjidhje të mundshme të konflikteve e implikimeve të tyre etike;</li> <li>• Të kuptojnë në thellësi marrëdhëniet e ndërveprimit midis praktikës morale e dilemave morale aktuale me teoritë etike.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe ngarkesa e tyre, është në përputhje me një program studimi të ciklit të dytë në fushën e etikës dhe leadership-it (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>), dhe përmban lëndë të përgjithshme dhe karakterizuese të përafërt me programe të ngjashme (kryesisht lëndët teorike), por të ndërthurura dhe me lëndë të cilat lidhen me kontekstin e Shqipërisë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit, sikurse dhe përmbajtja e tij, mundësojnë arritjen e objektivave formues (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>), transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve, për shkak të ngjashmërisë me programe të ofruara nga IAL të tjera dhe mundësisë që programi ofrohet edhe në gjuhën angleze (<b>Evidencë 2.7_Lista e programeve të studimit e miratuar për tu ofruar në gjuhë të huaj në kuadër të programit të ndërkombëtarizimit</b>), sikurse dhe punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve (duke qenë se i pajis me njohuri dhe kompetenca të përshtatshme), ose për të vijuar në programet e studimit të ciklit të tretë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i programeve të lëndëve/moduleve, si një ndër komponentët e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit (<b>Evidencë 2.16_Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit; Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Evidencë 3.15_Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës</b>) është një proces periodik i cili iniciohet kryesisht nga titullarët e lëndëve. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të tilla si: Teori Komunikimi, Komunikim Institucional dhe Menaxhim i Konflikteve (<b>Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b>), u evidentua mungesa e literaturës së 5 viteve të fundit në syllabuse, element i cili u diskutua edhe gjatë takimeve të zhvilluara në institucion (<b>Evidencë_Takimi me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit</b>) dhe argumenti kryesor i dhënë nga stafi akademik lidhet me mungesën e teksteve të viteve të fundit, të përkthyer në gjuhën shqipe, mangësi e cila tejkalohet nëpërmjet materialeve narrative të përgatitura nga ana e personelit akademik dhe që i vihen në dispozicion studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit, për shkak të mënyrës së organizimit (sipas Kategorive A-E, raporti midis komponentëve teorik dhe atyre</p>




<p>përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>praktik), garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, për studentët që përfundojnë një program studimi të ciklit të dytë, në fushën e etikës dhe lidërsip-it (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>). Kombinimi i njohurive teorike të përfituara në lëndë të tilla si Liria dhe të Drejtat e Njeriut, Morali dhe Politika, E Drejta dhe Shoqëria, Teori Etike Bashkëkohore, Etika në Administratë dhe Biznes, Teoritë e Përfaqësimit, Menaxhimi i Konfliktëve, kombinuar me lëndët me zgjedhje të tilla si E Drejta Administrative, Teori Komunikimi dhe Lidërsip-i dhe Përkatësi Gjinore japin njohuritë e përshtatshme teorike për një program të ciklit të dytë në fushën e etikës dhe lidërsip-it. Njohuritë teorike ndërthuren me aspektet praktike, pjesë e seminareve, projekteve, detyrave të kursit dhe prezantimeve dhe praktika profesionale, të cilat shërbejnë për të formuar kuadrin e plotë të përgatitjes në fushën përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e studimeve në programe të ciklit të tretë, sikurse dhe mundësinë e punësimin të të diplomuarve në këtë program studimi (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë 4.8_Të dhëna për regjistrimin, ecurinë; Evidencë 4.14_Të dhëna për punësimin e studentëve</b>). Lëndët e këtij programi studimi i pajisin studentët jo vetëm me njohuri të përgjithshme, por edhe me njohuri të specializuara në disiplinën e etikës dhe lidërsip-it.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Si nga dokumentacioni i administruar, ashtu edhe nga vizitat e zhvilluara në institucion (<b>Evidencë_Takimi me Dekanin, Drejtuesin e Departamentit, GVB</b>), deklarohet se në funksion të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjes me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen me bashkëpunëtorë dhe partnerë nga tregu i punës (<b>Evidencë 2.16_Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit; Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Evidencë 3.15_Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës</b>). Ndryshimet në programin e studimit, si ato nën 20% ashtu edhe ato mbi 20% (të cilat i nënshtrohen procedurës së riorganizimit), nisin me identifikimin e nevojës për ndryshimet në programin e studimit dhe përgatitjen e dokumentacionit/ argumentimit për këto ndryshime. Gjatë diskutimeve me Drejtuesin e Departamentit dhe anëtarët e GVB (<b>Evidencë_Takimi me Drejtuesin e Departamentit dhe GVB</b>), u argumentua se personeli akademik me kontratë, shërben si një ndër mekanizmat kryesor për t'u konsultuar lidhur me nevojën për ndryshime në programin e studimit, me qëllim marrjen e propozimeve nga tregu i punës, duke qenë se PAE janë të angazhuar në</p>



	sektorin publik dhe atë privat.		
<b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit ( <b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b> ) nëpërmjet kombinimit të veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve. <i>Por, sikurse është argumentuar edhe më parë, është e nevojshme që në kategorinë A të shtohet një lëndë për përgatitjen metodologjike (Metoda Kërkimi), e cila do i ndihmojë studentët për të avancuar në kërkimin shkencor dhe në ciklin e tretë të studimeve.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Në këtë program studimi, janë angazhuar: <ul style="list-style-type: none"> <li>Në vitin akademik <b>2018-2019: 8 PAE</b>, me kualifikimin 1 Prof. As., 6 Dr., dhe 1 Msc., dhe <b>10 PAK</b>, me kualifikimin 2 Dr. dhe 8 Msc.;</li> <li>Në vitin akademik <b>2019-2020: 7 PAE</b>, me kualifikimin 1 Prof. As., 5 Dr., dhe 1 Msc., dhe <b>11 PAK</b>, me kualifikimin 3 Dr. dhe 8 Msc.;</li> <li>Në vitin akademik <b>2020-2021: 7 PAE</b>, me kualifikimin 1 Prof. As., 5 Dr., dhe 1 Msc., dhe <b>15 PAK</b>, me kualifikimin 5 Dr., dhe 10 Msc.;</li> <li>Në vitin akademik <b>2021-2022: 6 PAE</b>, me kualifikimin 1 Prof. As., dhe 5 Dr., dhe <b>13 PAK</b>, me kualifikimin 1 Prof., 4 Dr., dhe 8 Msc. (<b>Evidencë 4.6 gjatë vizitës_Personeli akademik</b>).</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<i>Sikurse vihet re, personeli i angazhuar në këtë program studimi, jo gjithmonë i përmbush kërkesat ligjore në fuqi, lidhur me kualifikimin e tyre. Vihet re se në programin e studimit, pavarësisht se është një program i ciklit të dytë, në vitin akademik 21-22 janë angazhuar PAK me Msc, ndërsa në vitet e mëparshme ka patur të angazhuar edhe PAE me Msc., duke mos qenë kështu në përputhje me parashikimet e nenit 59, pika 6 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën</i>



e Shqipërisë”, ku parashikohet që personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Gjatë vizitës së zhvilluar në institucion dhe diskutimeve me anëtarët e GVB lidhur me këtë çështje, u parashtruan argumentet:

- Staf i me MSc. është i angazhuar si asistent i titullarëve të cilët kanë grada shkencore dhe tituj akademik;
- Angazhimi i tyre është bërë me qëllim dhënien e mundësisë për të bashkëpunuar me stafin akademik me më shumë eksperiencë (titullarët) por edhe si një lidhje me tregun e punës, duke qenë se pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar në pozicione të ndryshme. Në këtë këndvështrim ata mund të konsiderohen edhe si lektorë të ftuar;
- Si pasojë e bllokimit të studimeve doktorale për një kohë relativisht të gjatë, është e vështirë të gjendet staf me grada/tituj, të cilët kanë ekspertizën e nevojshme për t’u angazhuar në lëndët e këtij programi studimi.

GVJ mirëkupton argumentet dhe logjikën e parashtruar nga anëtarët e GVB-së, por parashikimet ligjore lidhur me nivelin e kualifikimit të nevojshëm të personelit akademik të angazhuar në programet e studimit të ciklit të dytë, janë të qarta dhe pengojnë angazhimin e tyre.

***GVJ rekomandon që në vijim, personeli akademik me MSc. të angazhohet vetëm në nivelin Bachelor dhe Institucioni të marrë masa që të angazhojë në këtë program studimi personel akademik me kualifikimin e kërkuar sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.***

Gjithashtu, vlen të theksohet se edhe pse personeli akademik i angazhuar me MSc. nuk ka nivelin e duhur të kualifikimit, ata zotërojnë ekspertizën dhe eksperiencën e nevojshme, si dhe në të gjitha lëndët e programit të studimit ku janë angazhuar PAK me MSc., lënda ndahet midis tyre dhe PAE, të cilët kanë titull/gradë shkencore.


Gjithashtu, nga shqyrtimi i syllabuseve të programit (**Evidencë shtesë 5-7\_Programet mësimore të lëndëve**), evidentohet se ***jo të gjithë titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë “Profesor”***, sikurse parashikuar në nenin 59, pika 3 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. ***Për sa më lart, GVJ rekomandon që Institucioni të përcaktojë si titullarë të lëndëve personel akademik të kategorisë “Profesor”.***

Përsa i përket shpërndarjes së ngarkesës mësimore midis PAE/PAK, rezultojnë si në vijim:

- Në vitin akademik 2018-2019: **58.4%** e ngarkesës mësimore është



	<p>mbuluar nga PAE, ndërsa 41.6% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAK;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në vitin akademik 2019-2020: 60.9% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAE, ndërsa 39.1% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAK;</li> <li>• Në vitin akademik 2020-2021: 50% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAE, ndërsa 50% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAK;</li> <li>• Në vitin akademik 2021-2022: 54.05% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAE, ndërsa 45.95% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga PAK (Evidencë 4.6 gjatë vizitës_Personeli akademik).</li> </ul> <p><i>Për sa më lart, ngarkesa mësimore në këtë program studimi nuk mbulohet së paku 70% nga personeli akademik efektiv, sikurse kërkohet nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Institucioni duhet të marrë masa për shtimin e ngarkesës së PAE dhe reduktimin e ngarkesës së PAK, për të shkuar drejt raportit së paku 70/30.</i></p> <p>Lidhur me ngarkesën totale të personelit akademik, në të gjithë programet e studimit, konstatohet se jo gjithmonë respektohen parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Evidentohen 3 raste kur personeli akademik është i angazhuar në 7 lëndë, në programe të ndryshme studimi, në një kohë që aktet nënligjore në fuqi parashikojnë angazhim deri në 3 lëndë semestrale. (Evidencë_Udhëzim nr. 37, datë 04.12.2018 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”; Evidencë shtesë 4.6_Personeli akademik).</p> <p>Rekomandohet që institucioni të marrë masa për uljen e ngarkesës së PAE (referuar numrit të lëndëve) dhe të shtojë personelin akademik të kësaj kategorie.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi, rezulton se fusha akademike-kërkimore, sikurse dhe eksperiencia profesionale, janë në përputhje me programin e studimit dhe lëndët/modulet në të cilat ato janë të angazhuar (Evidencë 4.16_CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm (Evidencë 3.17_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimi) të cilat vlerësohen të përshtatshme kryesisht për zhvillimin e praktikës profesionale. Edhe për komponentët e tjerë, të tillë si Diplomimi,</p>




kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	vlerësohet se institucioni garanton kapacitetet e nevojshme për realizimin e tyre me sukses ( <b>Evidencë 2.11_Rregullore e diplomimit; Evidencë 4.5_Paketa e punimit të diplomës</b> ). Mbështetja institucionale për praktikën profesionale dhe punimin e diplomës, u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Personeli ndihmës i angazhuar në këtë program studimi, konsiderohet i përshtatshëm. Për vetë natyrën e programit të studimit, vlerësohet se ky kriter përmbushet ( <b>Evidencë 4.6 gjatë vizitës Personeli akademik</b> ). Përveçse personelit ndihmës akademik, në mbështetje të realizimit të këtij programi janë si punonjësit e IT ashtu edhe punonjësit e bibliotekës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht <b>X</b>	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### Standardi II.6

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Si nga dokumentacioni i administruar, ashtu edhe nga vizitat e zhvilluara në institucion ( <b>Evidencë Takimi më Drejtuesin e Departamentit dhe GVB</b> ), deklarohet se në funksion të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjes me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen me bashkëpunëtorë dhe partnerë nga tregu i punës ( <b>Evidencë 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit; Evidencë 3.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Evidencë 3.15 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në	Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të programit të studimit është e parashikuar në aktet e brendshme rregullatore ( <b>Evidencë 2.16 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit; Evidencë 3.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Evidencë 3.15 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës</b> ). Përfshirja realizohet si nga




<p>funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>vlerësimet që studentët bëjnë nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e programit dhe procesit në tërësi, ashtu edhe nëpërmjet zhvillimit të takimeve me ta apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet kolegjiale të institucionit. Kontakti me studentët dhe me përfaqësues të tjerë nga tregu i punës, mbahet kryesisht nga koordinatori i programit të studimit (<b>Evidencë 3.12_Përshkrimi i detyrave të Koordinatorit të Programit të Studimit</b>).</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të programit të studimit zhvillohet si gjatë kohës që studentët ndjekin programin e studimit, ashtu edhe pas diplomimit të tyre. (<b>Evidencë 2.16_Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit; Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Evidencë 3.15_Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës</b>). Ky është një element pozitiv, duke qenë se Alumni njohin si programin e studimit, ashtu edhe kërkesat dhe pritshmëritë e tregut të punës për studentë të diplomuar në këtë program studimi. Angazhimi i Alumni si personel akademik me kohë të pjesshme apo si lektorë të ftuar, është një tjetër tregues i përfshirjes së studentëve të diplomuar në procesin e përmirësimit të programit të studimit.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Në kuadër të procesit të përmirësimit dhe pasurimit të ofertës akademike, institucioni bashkëpunon me institucione dhe aktorë të ndryshëm nga tregu i punës (<b>Evidencë 2.23_Politika e FSHS për bashkëpunimin dhe partneritetin; Evidencë 3.17_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidencë 3.19_Raport analitik për marrëveshjet e kryera</b>). Zhvillimi i konferencës vjetore të Filozofisë, me bashkëpunëtorë e pjesëmarrës nga institucione të tjera, zhvillimi i praktikave mësimore në institucione të studentëve në prag diplomimi, sikurse dhe angazhimi i PAK të cilët janë të punësuar me kohë të plotë në institucione të tjera, janë tregues të përmbushjes së këtij kriteri (<b>Evidencë 4.19_Dosje e leksioneve dhe aktiviteteve të Departamentit; Evidencë 3.18_Raporte vjetore të Departamentit</b>).</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p><b>Standardi II.7</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë</p>	<p>Prioritetet dhe objektivat kryesore të programit të studimit janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit</b>). Bazuar në këto akte, programi</p>




të institucionit.	i studimit: mundëson integrimin e mësimdhënies me studimet dhe kërkimin shkencor; siguron kushtet që mësimdhënia të realizohet nga një staf akademik me tituj e grada shkencore, ofron kushte e mundësi që stafi e studentët të gëzojnë liri të plotë akademike dhe pavarësi organizative në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, duke qenë në përputhje me objektivat madhore të institucionit ( <b>Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Respektimi i lirisë akademike në veprimtarinë e mësimdhënies dhe veprimtaritë e kërkimit shkencor është i parashikuar në aktet e brendshme rregullatore ( <b>Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë 1.5_Kodi i Etikës; Evidencë 2.8_Informacion për respektimin e lirisë akademike dhe të autonomisë organizative dhe financiare</b> ). Zbatimi në praktikë i këtyre parimeve u konfirmua edhe gjatë takimeve me stafin akademik.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit, sikurse dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, GVJ konstaton se programi mundëson angazhimin e studentëve në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, si në mënyrë individuale (detyrat e kursit/projektet) ashtu edhe si bashkëpunim midis studentëve dhe personelit akademik. Përfshirja e studentëve në konferencat shkencore të organizuara nga Departamenti, janë tregues të përmbushjes së këtij kriteri. Ndër aktivitete kryesore në të cilat janë angazhuar studentët, mund të përmendim: Orët e kinemasë dhe imazhi fotografik; Konferenca shkencore ndërkombëtare “Elitat me mendim dhe platforma idesh, jeta mendonjëse dhe debati për projektimin e shqiptarit dhe Shqipërisë në prosperitet”, (ku referuan 6 studentë), Ëorkshopi “Universiteti dhe filozofia përballë modeleve të zhvillimit të sotëm botëror” (ku kanë referuar 3 studentë) ( <b>Evidencë 4.7_Të dhëna të plota për kërkimin shkencor; Evidencë 4.19_Dosje e leksioneve dhe aktiviteteve të Departamentit</b> ).
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i përfshirë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat kanë si qëllim zgjerimin dhe thellimin e njohurive shkencore. Ndër angazhimet/projektet kryesore mund të përmendim: Angazhimi si ekspertë në projektet: Etika në sistemin arsimor shqiptar; Inisiativa Antikorrupsion. Departamenti i Filozofisë ka zbatuar 6 projekte. ( <b>Evidencë 2.18_Analizë vjetore e punës së FSHS; Evidencë 2.23_Politika e FSHS për bashkëpunimin dhe partneritetin; Evidencë 4.7_Të dhëna të plota për kërkimin shkencor; Evidencë 4.11_Të dhëna për aktivitetin dhe kualifikimet e stafit akademik; Evidencë 4.19_Dosje e leksioneve dhe aktiviteteve të Departamentit</b> ).
<b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e	Departamenti dhe personeli akademik mbështeten financiarisht nga



aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	institucioni, ndërsa administrimi i të ardhurave bëhet në mënyrë të centralizuar dhe jo nga vetë Departamenti ( <b>Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT; Evidencë 1.16_Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor; Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik</b> ). <i>Me qëllim rritjen e numrit të aktiviteteve studimore dhe kërkimore, rekomandohet që personeli akademik të rrisë numrin e aplikimeve për të përfituar nga fondet për mbështetjen financiare për kërkimin shkencor.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni mbështet në aspektin financiar dhe administrativ angazhimin e personelit akademik në projekte kërkimore, duke siguruar bashkëpunim edhe me struktura të tjera si në nivel institucioni ashtu edhe me bashkëpunëtorë të jashtëm. Organizimi i konferencave, ëorkshopeve, botimi periodik i revistës, sikurse dhe mbështetja për pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit, janë tregues të kësaj mbështetje. ( <b>Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT; Evidencë 1.16_Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor; Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik; Evidencë 2.23 Politika e FSHS për bashkëpunimin dhe partneritetin; Evidencë 2.24_Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe studentëve; Evidencë 3.21_Tabela përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese; Evidencë 4.12_Lista e projekteve që kanë pasur ndikim në program</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Pavarësisht se Departamenti ka ekspertizën e nevojshme dhe të kualifikuar për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor, <b><i>GVJ nuk arrin të evidentojë raste konkrete të bashkëpunimit midis Departamentit dhe aktorëve të tjerë, të cilat të kenë ardhur si rrjedhojë e kërkesës së paraqitur nga aktorët e jashtëm. Në këtë kushte është e nevojshme që Departamenti të angazhohet në rritjen e nivelit të bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.</i></b>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë	Departamenti organizon në mënyrë periodike aktivitete shkencore me pjesëmarrjen dhe kontributin e personelit akademik dhe të studentëve, të cilat ndihmojnë në arritjen e objektivave të tyre. Ndër aktivitetet




personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	kryesore në të cilat janë angazhuar studentët, mund të përmendim: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Orët e kinemasë dhe imazhi fotografik.</li> <li>• Konferenca shkencore ndërkombëtare ‘Elitat me mendim dhe platforma idesh, jeta menodnjëse dhe debati për projektimin e shqiptarit dhe Shqipërisë në prosperitet (ku referuan 6 studentë).</li> <li>• Workshopi ‘Universiteti dhe filozofia përballë modeleve të zhvillimit të sotëm botëror (ku kanë referuar 3 studentë). (Evidencë 2.18_Analizë vjetore e punës së FSHS; Evidencë 4.12_Lista e projekteve që kanë pasur ndikim në program; Evidencë 4.19_Dosje e leksioneve dhe aktiviteteve të Departamentit).</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>
		X		

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>
		X		

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, përbën një objektivi të rëndësishëm të institucionit, e përcaktuar në dokumente kryesore strategjike (Evidencë 1.4_ <b>Strategjia e zhvillimit të UT</b> ; Evidencë 4.18_ <b>Mësimdhënia inovative</b> ). Në funksion të përmbushjes së këtij objektivi, institucioni zhvillon trajnime për stafin akademik dhe administrativ (Evidencë 2.21_ <b>Politika për zhvillimin profesional të personelit akademik</b> ). Ndër veprimtaritë kryesore janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kurs trajnimi për certifikatë në mësimdhënie në arsimin e lartë;</li> <li>• Kurse të shkurtra (sipas nevojave të identifikuara dhe në mbështetje të zbatimit të risive pedagogjike);</li> <li>• Konferenca, seminare, shkolla verore dhe ditët e informimit;</li> <li>• Ditët e zhvillimit profesional (të cilat organizohen në bazë Fakulteti ose Departamenti).</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në	Departamenti, në bashkëpunim me NJSBC, zhvillojnë mekanizma monitorimi dhe vlerësimi, të cilat aplikohen në mënyrë periodike. Ky








<p>mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>proces realizohet nëpërmjet mekanizmave të ndryshme, ku ndër më kryesorët janë anketat e studentëve, fokus-grupet, raportet semestrale dhe vjetore të njësisë bazë (Evidencë 1.11_Manuali i cilësisë; Evidencë 1.13_Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik; Evidencë 1.14_Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidencë 2.14_Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS; Evidencë 2.18_Analizë vjetore e punës së FSHS).</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në vlerësimin periodik të procesit mësimor si nëpërmjet pyetësorëve (Evidencë 1.11_Manuali i cilësisë; Evidencë 1.13_Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik; Evidencë 1.14_Paketa e instrumenteve të cilësisë) por edhe në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet kërkesave dhe ankesave që mund t'i drejtojnë Departamentit. Gjatë takimit të zhvilluar me studentët e këtij programi studimi, doli në pah se studentët kishin hapësirat e nevojshme për të adresuar ankesat e ndryshme që mund të kishin lidhur me procesin mësimor, por edhe aspekte të tjera të jetës studentore.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Raporti vjetor i hartuar nga NJSBC, i vendoset në dispozicion palëve të përfshira në proces si dhe strukturave përgjegjëse në Rektoratit e Universitetit të Tiranës (Evidencë 1.2_Statuti UT; Evidencë 1.6_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Evidencë 2.14_Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS; Evidencë 2.18_Analizë vjetore e punës së FSHS). Në faqen zyrtare të UT mund të aksesohen informacione lidhur me Politikën e Transparencës, në të cilin ka dhe një seksion dedikuar çështjeve që lidhen me sigurimin e cilësisë (<a href="https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/">https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/</a>). Raportet e vlerësimit institucional gjenden në seksionin e dedikuar sigurimit të cilësisë, në faqen zyrtare të FSHS (<a href="https://fshs-ut.edu.al/?page_id=9166">https://fshs-ut.edu.al/?page_id=9166</a>).</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Bazuar në gjetjet e evidentuara në kriteret e mësipërme, njësitë përgjegjëse nxisin dhe inkurajojnë përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve, por edhe diskutimit individual apo gjatë mbledhjeve të departamenteve, të problematikave të evidentuara dhe diskutimit mbi masat e nevojshme për përmirësimin e cilësisë. Ky element u evidentua edhe gjatë takimeve në institucion (Evidencë_Takimi me Drejtuesin e Departamentit; anëtarët e GVB, përfaqësues të NJSBC).</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

**Standardi III.2**

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, të tilla si leksionet, seminarët, detyrat e kursit, etj., janë të përcaktuara në planin mësimor (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>), në syllabuset e lëndëve (<b>Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b>), sipas përcaktimeve në Rregulloren e Programit të Studimit (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve me përfaqësues të ndryshëm (<b>Evidencë Takimi me Drejtuesin e Departamentit; anëtarët e GVB, personelin akademik; studentët</b>) u konstatua se personeli akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma të ndryshme të mësimdhënies. Duke qenë se fusha e programit të studimit, etika dhe lidhshmëria, ka një natyrë kryesisht teorike, format klasike të mësimdhënies janë mbizotëruese, të cilat adoptohen edhe në bazë të nevojave të studentëve (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Bazuar edhe në aktet e brendshme rregullatore mbi aspektet didaktike (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit</b>), institucioni mbështet stafin akademik të përcaktojë në mënyrë autonome metodat pedagogjike, në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave të programit të studimit në tërësi, por edhe lëndëve apo moduleve të veçanta, si pjesë përbërëse të kurrikulës. Zhvillimi profesional i personelit akademik, ku përfshihet edhe përmirësimi i kompetencave didaktike, është në fokusin e institucionit. Këto elemente konstatohen si nga takimet e zhvilluara në institucion (<b>Evidencë Takimi me Drejtuesin e Departamentit; anëtarët e GVB, personelin akademik; studentët</b>), ashtu edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë në kuadër të akreditimit të këtij programi studimit (<b>Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga institucioni (<b>Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve; Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit</b>), konstatuar edhe gjatë takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, por edhe me studentët e këtij programi studimi, arrihet në konkluzionin se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe</p>




	përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, sipas tematikave dhe profilit të lëndëve ku ata janë të angazhuar, si titullar apo si asistentë.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Rishikimi i programeve të lëndëve <b>(Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve)</b> si në aspektin përbajtësor, ashtu edhe metodat e mësimdhënies, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e studentëve <b>(Evidencë_Takimi me Drejtuesin e Departamentit; anëtarët e GVB, personelin akademik; studentët)</b> dëshmon për përbushjen e këtij kriteri nga ana e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit në proces akreditimi.		
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Kombinimi i metodave klasike me ato interaktive, u konstatua si nga takimet e zhvilluara me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe me studentët, ashtu edhe nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, në të cilat, në seksionin e përshkrimit të seminarit për secilën temë, evidentohen element të këtij kombinimi <b>(Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve)</b> .		
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Përdorimi i metodave inovative, sikurse dhe kombinimi i metodave klasike me ato interaktive, garantojnë që format dhe metodat e mësimdhënies të inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit. Organizimi i detyrave në grup apo individuale, prezantimet, etj., ndikojnë në përbushjen e këtij kriteri, i cili u konstatua edhe gjatë takimeve të zhvilluara me studentët e këtij programi studimi <b>(Evidencë_Takimi me studentët e programit të studimit)</b> .		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe vëzhgimit të infrastrukturës në funksion të programit të studimit, u konstatua se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe të mirëmbajtura <b>(Evidencë 4.13_Të dhëna për infrastrukturën; Evidencë)</b>. Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të programit të studimit, ka një sipërfaqe totale prej rreth 7154 m<sup>2</sup>, ku ndër mjedise kryesore mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 22 salla për leksione/seminare, me sipërfaqe 1854 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 2 salla për aktivitete promovuese, me sipërfaqe 285 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale - me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 1 sallë interneti – me sipërfaqe 45.5 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 2 salla biblioteke - me sipërfaqe 189.5 m<sup>2</sup>.</li> </ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 mjedis për fotokopje, me sipërfaqe 12 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 1 zyrë informacioni për studentët, me sipërfaqe 9 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 14 nyje hidrosanitare, me sipërfaqe 51 m<sup>2</sup>.</li> </ul> <p>Edhe mjediset e dedikuara për stafin, të cilat kanë një sipërfaqe prej 823 m<sup>2</sup>, vlerësohen si të përshtatshme dhe përbëhen nga zyrat për drejtuesit (1), sekretarinë mësimore (2), departamentet dhe personelin akademik (30), financën (1), NJSBC (1), Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve (1), IT (2) dhe nyjet hidrosanitare për personelin akademik dhe administrativ (20).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Sallat në të cilat zhvillohen leksionet dhe seminarët, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme, të tilla si kompjuter, projektor, akses në internet. Në dispozicion të zhvillimit të orëve në të cilat është i nevojshëm përdorimi i IT, institucioni është i pajisur me laboratorin e informatikës. Në funksion të zhvillimit të programit të studimit, në dispozicion të studentëve është edhe biblioteka, në të cilën gjendet literaturë fizike sikurse dhe disa poste pune të pajisura me kompjuter, në të cilët studentët mund të aksesojnë bibliotekat online (<b>Evidencë 4.13_Të dhëna për infrastrukturën; Evidencë 2.29_Informacion për bibliotekën</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Laboratori i informatikës, sikurse dhe sistemi i IT në tërësinë e tij, shfrytëzohet nga personeli akademik dhe nga studentët e këtij programi studimi, në funksion të realizimit të procesit mësimor (<b>Evidencë 1.10_Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT</b>). Sikurse u analizua edhe në kriterin e mësipërm, edhe në ambientet e bibliotekës, studentët por edhe personeli akademik, kanë mundësinë të aksesojnë bibliotekat online (<b>Evidencë 4.13_Të dhëna për infrastrukturën; Evidencë 2.29_Informacion për bibliotekën</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse, e përcaktuar në syllabuset e çdo lënde (<b>Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b>), vlerësohet si e përshtatshme në funksion të garantimit të marrjes së dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Biblioteka ka aktualisht një fond të përshtatshëm dhe institucioni ndjek një politikë të vazhdueshme për pasurimin e këtij fondi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Fondi i bibliotekës në dispozicion të fushës studimore të këtij programi studimi, vlerësohet si i përshtatshëm (<b>Evidencë 2.29_Informacion për bibliotekën</b>). Biblioteka ka hapësira optimale dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. Pjesë e bibliotekës janë edhe libraritë online, të tilla si UNRISD, Accueil, EuroPS Services, Springer, Sagepublications, të cilat mund të aksesohen nga studentët në ambientet e bibliotekës. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, institucioni aktualisht po pasuron fondin ekzistues të literaturës fizike (<b>Evidencë 2.30_Buxhetimi për pasurimin e</b></p>






	<b>bibliotekës; Evidencë 2.31_Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS).</b>		
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Pjesë e bibliotekës janë edhe libraritë online, të tilla si UNRISD, Accueil, EuroPS Services, Springer, Sagepublications, të cilat mund të aksesohen nga ambientet e bibliotekës, si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies ( <b>Evidencë 2.29_Informacion për bibliotekën</b> ).		
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Gjatë takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konstatua se infrastruktura laboratorike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e studentëve. Kjo infrastrukturë përdoret si për aksesimin e materialeve të ndryshme, ashtu edhe për përgatitjen e detyrave, prezantimeve dhe punimeve të diplomave ( <b>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</b> ).		
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Personeli akademik dhe studentët e këtij programi studimi, përdorin platformën Microsoft Teams. Përdorimi i kësaj platformë ka gjetur zbatim të gjerë, kryesisht gjatë pandemisë Covid-19 ( <b>Evidencë 1.15_Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë; Evidencë 1.17_Për disa shtesa në udhëzuesin UT për zhvillimin e mësimin në distancë</b> ).		
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Komunikimi dhe shkëmbimi i materialeve midis personelit akademik dhe studentëve, zhvillohet kryesisht nëpërmjet adresave të e-mailit, sikurse dhe klasat në platformën Microsoft Teams ( <b>Evidencë_Takimi me Drejtuesin e Departamentit; anëtarët e GVB, personelin akademik; studentët</b> ).		
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sikurse dhe nga informacioni i mbledhur gjatë vizitës në institucion ( <b>Evidencë_Takimi me Drejtuesin e Departamentit; anëtarët e GVB, personelin akademik; studentët</b> ), GVJ konstaton se institucioni informon studentët mbi rregullat e lidhura me procesin e diplomimit ( <b>Evidencë 2.11_Rregullore e Diplomimit; Evidencë 4.5_Paketa e punimit të diplomës për programet e studimit</b> ). Për secilin student që do të zhvillojë një temë diplome, Departamenti cakton një pedagog udhëheqës, i cili orienton dhe mbështet studentin që nga momenti i përzgjedhjes së temës e deri në mbrojtjen e saj.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X








**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit bashkëpunon me njësi të tjera në nivel njësie kryesore, por dhe në nivel institucional, të tilla si Komisioni i Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë në nivel institucional (KPSSC), Njësia e sigurimit të cilësisë në nivel Universiteti, Njësia e sigurimit të cilësisë e njësisë kryesore dhe njësia përgjegjëse për kurrikulat në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies (<b>Evidencë 1.6_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Evidencë 2.14_Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS; 2.16_Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimin të programeve të studimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe bashkëpunon me strukturat e tjera institucionale, sikurse dhe me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit (<b>Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS</b>). Mekanizmat për vlerësimin e procesit mësimor (si pyetësorët dhe fokus grupet), shpërndarja e ngarkesës dhe angazhimi i stafit në përputhje me ekspertizën e tyre, janë disa nga treguesit për respektimin e këtij kriteri nga ana e njësisë përgjegjëse.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Liria akademike, sikurse dhe angazhimi i një personeli me kualifikime apo eksperiencë, dhe formim të përshtatshëm në disiplinat që mbulojnë, janë tregues se njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies (<b>Evidencë 2.8_Informacion për respektimin e lirisë akademike dhe të autonomisë organizative e financiare</b>). Kjo u konstatua edhe gjatë takimit të zhvilluar në institucion me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni mbështet kualifikimin e vazhdueshëm dhe kërkimin shkencor të personelit akademik, nëpërmjet organizimit të konferencave, mundësisë për të botuar në revistën shkencore të universitetit, angazhimit në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, sikurse dhe mobilitetit të stafit akademik. Personeli akademik efektiv i Departamentit në vitet e e fundit ka realizuar 41 botime shkencore; numri i projekteve të zbatuara në shkallë Departamenti/Fakulteti është 6; numri i aktiviteteve shkencore të organizuara 18 dhe numri i pjesëmarrësve rreth 200. (<b>Evidencë 1.16_Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT; Evidencë 2.20_Model i marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik; Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik; Evidencë 4.7_Të dhënat e plota për kërkimin</b></p>




	<p><b>shkencor në kuadër të programit të studimit).</b> Gjatë takimeve në institucion, përfaqësuesit deklaruan se ekziston një fond i veçantë në buxhetin vjetor, i cili i dedikohet mbështetjes së personelit akademik për kualifikim të vazhdueshëm në fushën e kërkimit shkencor (<b>Evidencë_Takimi me anëtarët e GVB dhe personelin akademik).</b></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në kuadër të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja, njësitë përgjegjëse organizojnë trajnime të vazhdueshme për personelin akademik (<b>Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik).</b></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit por edhe nga informacioni i marrë në takimet e zhvilluara në institucion (<b>Evidencë_Takimi me personelin akademik),</b> GVJ konstaton se personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit, për komponentët ku ata janë të angazhuar si titullarë apo si asistentë, dhe është i angazhuar për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimit të metodave inovative, të cilat reflektohen në syllabusin e lëndës, por edhe në feedback-un që merret nga mekanizmat e monitorimit të cilësisë (<b>Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve).</b></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, nga ana e përfaqësuesve (<b>Evidencë_Takimi me Drejtuesin e Departamentit; Takimi me personelin akademik)</b> u deklarua se implementimi i metodave të reja dhe rezultatet e tyre, analizohen nga personeli akademik, duke marrë në konsideratë edhe feedback-un e marrë nga mekanizmat për sigurimin e cilësisë (<b>Evidencë 2.15_Politika e sigurimit të cilësisë FSHS)</b> dhe janë objekt i diskutimeve në mbledhjet e Departamentit.</p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni angazhon lektorë dhe kërkues shkencor për shkëmbimin e ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në kuadër të bashkëpunimi me partnerë të ndryshëm. Ndër partnerët kryesor mund të përmendim përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Universiteti Ss. Cyril and Methodius, Universiteti Louvain, Belgjike, etj. (<b>Evidencë 4.12_Lista e projekteve që kanë pasur ndikim në program; Evidencë 4.19_Dosja e leksioneve dhe aktiviteteve të Departamentit).</b></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X







<b>Standardi III.5</b>			
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore ( <b>Evidencë 3.3_Rregullore e Programit të Studimit</b> ), sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë ( <b>Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b> ), të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri. Në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe pesha specifike në përqindje e secilit prej komponentëve të vlerësimit. Format e kontrollit të vazhdueshëm, të cilat kanë shpërndarje të ndryshme në lëndë të ndryshme, janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• pjesëmarrja aktive në seminare – 10-20%;</li> <li>• detyrë kursi/temë studimore – 20%;</li> <li>• provimi ndërmjetëm – 0-20%;</li> <li>• provimi përfundimtar – 60%.</li> </ul>		
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në syllabuset e lëndëve ( <b>Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b> ), të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri, janë të përcaktuara format e kontrollit të dijeve, të cilat janë në përputhje me aktet e brendshme rregullatore ( <b>Evidencë 3.3_Rregullore e Programit të Studimit</b> ). Vlerësimi i një lënde mund të bëhet me provim (me shkrim, gojë ose i kombinuar), me detyra kursi/projekte, ose i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi. Gjatë takimit të zhvilluar me studentët, u konstatua se ata dispononin informacionin e plotë lidhur me format dhe kriteret e vlerësimit për secilën lëndë.		
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme dhe përfshijnë: pjesëmarrjen aktive në seminare, dorëzimi i detyrave/projekteve, provim i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar ( <b>Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b> ). Këto komponentë, sikurse dhe pesha specifike e tyre, është e ndryshme në lëndë të ndryshme.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë	Procesi i vlerësimit realizohet gjatë gjithë vitit akademik (semestrave), i cili konstatohet nga vlerësimi për dy provime (i ndërmjetëm dhe përfundimtar) në disa lëndë, pjesëmarrjes aktive në seminar, detyrat e





gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	kursit dhe projektet, dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar ( <b>Evidencë 3.3_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, por edhe gjatë vizitës në institucion ( <b>Evidencë Takimi me Drejtuesin e Departamentit, GVB dhe Sekretarinë Mësimore</b> ), <i>GVJ nuk konstatoi përdorimin e sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat do të ndikonin në reduktimin e formave të abuzimit dhe rritjes së transparencës. Pavarësisht se provimet zhvillohen në sekretuara, mënyra e zhvillimit të këtij procesi nuk garanton përmbushjen e këtij kriteri. GVJ rekomandon që institucioni të marrë masa për vendosjen në përdorim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat do të ndikonin në reduktimin e formave të ndryshme të abuzimit sikurse dhe rritjen e transparencës.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Zhvillimi i provimeve është i përcaktuar në aktet e brendshme rregullore ( <b>Evidencë 3.3_Rregullore e Programit të Studimit</b> ), në të cilat parashikohet se Komisioni i vlerësimit si rregull përbëhet nga dy pedagogë, ndërsa kur lëndën e zhvillojnë më shumë se dy pedagogë, të gjithë ata janë anëtarë të komisionit të vlerësimit.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Provimet me shkrim i nënshtrohen procesit të sekretimit dhe gjatë zhvillimit të provimit klasat monitorohen nga Komisioni i vlerësimit. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Sekretimi bëhet nëpërmjet sekretimit të thjeshtë ( <b>Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS; Evidencë Takimi me Drejtuesin e Departamentit, Sekretarinë Mësimore</b> ).
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë vizitave në institucion ( <b>Evidencë Takimi me personelin akademik; Takimi me studentët</b> ), u konstatua se pas zhvillimit të provimeve dhe publikimit të rezultateve, pedagogët diskutojnë me studentët mbi zgjidhjen e tij, duke ndikuar në përmirësimin e dijeve në vijim. Kjo e drejtë është e përcaktuar edhe në aktet e brendshme rregullore ( <b>Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS</b> ).
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në aktet e brendshme rregullore, janë të përcaktuara rregullat për zhvillimin e procesit të provimeve ( <b>Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS; Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit</b> ). Procesi i sekretimit, sikurse dhe monitorimi i sallës gjatë zhvillimit të provimeve, janë mekanizma të cilat ndikojnë në përmbushjen e këtij kriteri. Lidhur me fenomenin e plagjiaturës, gjatë takimeve të zhvilluara në institucion ( <b>Evidencë Takimi me personelin akademik; Takimi me studentët e</b>



	<b>programit të studimit) u deklarua se ky fenomen nuk tolerohet dhe në rast të konstatimit, detyra/provimi/punimi i diplomës, vlerësohet me notën 4. Institucioni ka në përdorim sistemin antiplagjiaturë, Turnitin, i cili i vjen në ndihmë personelit akademik, për shmangien e këtij fenomeni (Evidencë_Takimi me personelin akademik).</b>		
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e provimeve u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim, brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Rezultatet komunikohen individualisht ( <b>Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS</b> ). Nga informacioni i marrë gjatë takimit me studentët e programit të studimit, rezultatet e vlerësimit bazohen mbi meritë.		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit, sikurse dhe të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa paraqitet me shkrim tek përgjegjësi i departamentit ose sekretaria e departamentit, 48 orë nga marrja dijani për rezultatin e provimit. Përgjegjësi i departamentit verifikon pretendimet dhe kur e ka të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni Dekanin, i cili brenda 48 orësh nga marrja dijani për ankesën, ngre komisionin <i>ad-hoc</i> . Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ( <b>Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS</b> ).		
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Sikurse është analizuar edhe në kriterin e mësipërm, institucioni ka të mirë përcaktuar procedurën për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ( <b>Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS</b> ). Kjo e drejtë e studentëve u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët e këtij programi studimi. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit. Përgjegjësi i Departamentit nëse verifikon shkelje të korrigjueshme, në bashkëpunim me Komisionin e Provimit, bëjnë korrigjimet e duhura, në të kundërt i propozon Dekanin, i cili pasi njihet me të gjithë procedurën dhe nëse gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për ri zhvillimin e provimit. Gjithashtu, studentit ka të drejtë të ankohet edhe për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa paraqitet me shkrim te Përgjegjësi i Departamentit ose Sekretaria e Departamentit, brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit të provimit. Nëse Përgjegjësi e ka të pamundur zgjidhjen e ankesës, ai vë në dijeni Dekanin, i cili brenda 48 orëve nga marrja në dijeni, ngre një komision ad-hoc. Me miratimin e Dekanin, Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>




**Standardi III.7**

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit, e kombinuar me mënyrën e zhvillimit të saj, garanton thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale ( <b>Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve</b> ). Viti i parë akademik nis me lëndë të përgjithshme, për të shkuar gradualisht në semestrat dhe vitet në vijim, drejtë lëndëve karakterizuese të programit, dhe deri tek praktika profesionale dhe diplomimi. <i>Sikurse është argumentuar edhe në Standardin II.1, Kriteri 6, është e nevojshme që në Kategorinë A të shtohet lënda e Metodave të Kërkimit.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit përmban lëndë për zhvillimin e aftësive në fushën e komunikimit, Teori Komunikimi dhe Komunikim Institucional). Programi ofrohet edhe në gjuhën angleze ( <b>Evidencë_Urdhër MAS Nr. 110, datë 04.03.2022 “Për miratimin e ofrimit dhe në gjuhën angleze të disa programeve të studimit në Universitetin e Tiranës”;</b> <b>Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b> ).
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Rishikimi i kompetencave dhe aftësive të fituara nga studenti në secilën lëndë është pjesë integrale e rishikimit të syllabuseve dhe përmirësimit të programit të studimit në tërësi ( <b>Evidencë 2.16_Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të programeve të studimit; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit</b> ).
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Gjatë takimeve të zhvilluara si me personelin akademik ashtu edhe me studentët, u konstatua se në përfundim të lëndëve/moduleve, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme të trajtuara në atë lëndë/modul dhe orienton studentët për implementimin e tyre.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në institucion zhvillohen leksione të hapura dhe aktivitete të tjera ekstrakurrikulare, të cilat lidhen si me zhvillimet e fundit në fushën e programit të studimit, ashtu edhe në fusha të tjera interdisiplinare apo me karakter praktik dhe aplikativ ( <b>Evidencë 3.18_Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik; Evidencë 4.15_Tabela përmbledhëse për trajnimet profesionale për studentët e diplomuar</b> ). Ndër aktivitetet kryesore përmendim: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitet për ditën e Europës;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Workshop “Identiteti dhe nacionaliteti në kontekstin e integritit European”.</li> <li>• Auditor i hapur “Europa dhe Shqipëria, një proces i trazuar që vijon”.</li> <li>• Trajnim profesional me temë “Etika në Komunikim”.</li> <li>• Diskutim i hapur me klubin e debatit me tematika të larmishme dhe dinamike.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në tërësi, mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në lëndë të ndryshme të programit të studimit (<b>Evidencë_Takimi me Drejtuesin e Departamentit; Takimi me personelin akademik; Takimi me studentët e programit të studimit</b>). Për vetë natyrën e programit të studimit, fushës së tij, nuk gjenden shumë element të lidhur me mundësi për të zhvilluar njohuri të marra në laboratorë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup. Në këtë mënyrë, studentët pajisen me aftësi dhe kompetenca për identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme në fushën e etikës dhe lidhshirësit (Evidencë_Takimi me Drejtuesin e Departamentit; Takimi me personelin akademik; Takimi me studentët e programit të studimit).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Organizimi i detyrave të kursit, sikurse dhe puna në grup apo individuale për seminarët në lëndë të ndryshme, janë tregues të krijimit të një klime të përshtatshme për përmbushjen e këtij kriteri. Ky element u konstatua edhe gjatë takimit me studentët e programit të studimit (<b>Evidencë_Takimi me studentët e programit të studimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Organizimi i konferencave, trajnimeve dhe leksioneve të hapura, ku studentët janë të ftuar të marrin pjesë, janë tregues të mbështetjes së studentëve si në aspektin organizativ ashtu edhe financiar (<b>Evidencë 2.24_Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studentëve; 3.17_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidencë 4.7_Të dhënat e plota për kërkimin shkencor në kuadër të programit të studimit</b>). Studentët, në mënyrë individuale apo në bashkëpunim me personelin akademik, janë angazhuar në aktivitete shkencore të ndryshme. Pjesëmarrja në këto aktivitete mundëson zhvillimin e ideve inovative, aftësive kërkimore, aftësive prezantuese dhe të folurit në publik, aftësi të cilat janë të domosdoshme për studentët e ciklit të dytë të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur</p>	<p>Bashkëpunimi me institucione të ndryshme ka rritur mundësinë për stafin akademik për të ndërthurur si format e mësimdhënies ashtu edhe për të rritur mobilitetin si të vetë stafit akademik, ashtu edhe studentëve (<b>Evidencë 2.24_Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studentëve; Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit;</b></p>




mobilitetin e studentëve	<b>Evidencë 3.18_Raport për veprimtarinë e programit të studimit).</b>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>	<b>Përmbyhet kryesisht</b>	<b>Përmbyhet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi III.8


**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në aktet e brendshme rregullatore është përcaktuar procedura e posaçme për mbrojtjen e diplomës ( <b>Evidencë 2.11_Rregullore e diplomimit; Evidencë 4.5_Paketa e punimit të diplomës; Evidencë 3.3_Rregullore e Programit të Studimit</b> ). Këto dokumente dhe informacioni mbi këtë proces, u vihet në dispozicion studentëve, gjë e cila u konstatua gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi ( <b>Evidencë_Takimi me studentët e programit të studimit</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Studentët asistohen për punimin dhe mbrojtjen e diplomës nëpërmjet vënies në dispozicion të informacioneve, udhëzimeve dhe caktimit të udhëheqësit ( <b>Evidencë 2.11_Rregullore e diplomimit; Evidencë 4.5_Paketa e punimit të diplomës; Evidencë 3.3_Rregullore e Programit të Studimit</b> ). Ky asistim u konstatua edhe gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi. Studentëve u vihet në dispozicion lista e personelit akademik dhe disa tema të mundshme punimi diplome. Studentët përzgjedhin udhëheqësin e tyre, nëpërmjet një kërkesë që i drejtohet Departamentit, i cili miraton listën përfundimtare të udhëheqësve, duke marrë në konsideratë ekspertizën dhe ngarkesën e personelit akademik. Udhëheqësi dhe studentët zhvillojnë takime të rregullta midis tyre, në funksion të mbarëvajtjes së procesit ( <b>Evidencë_Takimi me studentët e programit të studimit</b> ).
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Duke qenë se programi i studimit në proces vlerësimi është program studimi i ciklit të dytë Master i Shkencave, detyrimi përmbyllës realizohet vetëm nëpërmjet punimit të diplomës.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Studentët marrin orientimet e nevojshme për përcaktimin e temave të diplomës nga personeli akademik në bashkëpunim me sekretarinë. Kriteret dhe procedurat e diplomimit janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore. Departamenti publikon temat e mundshme të diplomave, sikurse përcakton edhe pedagogun udhëheqës, i cili asiston studentin në përgatitjen e punimit të diplomës, sipas standardeve të



	institucionit ( <b>Evidencë 2.11_Rregullore e diplomimit; Evidencë 4.5_Paketa e punimit të diplomës</b> ).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësi i diplomës asiston studentët që kanë udhëheqje në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, në bazë të temave të përzgjedhura nga studentët. Ky asistim u konfirmua edhe nga studentët, gjatë zhvillimit të takimit me ta ( <b>Evidencë Takimi me studentët e programit të studimit</b> ). Personeli akademik orienton studentët mbi mënyrën e formulimit të pyetësorëve dhe përgatitjes së intervistave, planit të punës, përdorimin e analizës sasiore dhe/ose cilësore, në varësi të llojit të studimit, etj.
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës garanton se punimi është realizuar sipas standardeve shkencore dhe përmbush kriteret institucionale për kërkimin shkencor ( <b>Evidencë 2.11_Rregullore e diplomimit; Evidencë 4.5_Paketa e punimit të diplomës</b> ). Përgatitja e punimit kryhet sipas një plani të dakordësuar ndërmjet udhëheqësit shkencor dhe studentit. Udhëheqësi miraton punimin përpara se studenti të paraqitet në komisionin për mbrojtjen e diplomës.
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi kryhet me pikë sipas skedës së vlerësimit që përfshihet në paketën e punimit të diplomës, pikë të cilat konvertohen në notë. Nota regjistrohet në procesverbal, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Vlerësimi i komunikohet studentit individualisht ( <b>Evidencë 2.11_Rregullore e diplomimit; Evidencë 4.5_Paketa e punimit të diplomës</b> ).
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin ( <b>Evidencë 2.11_Rregullore e diplomimit; Evidencë 3.8_Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës; Evidencë 3.9_Shkresa e QSHA për regjistrimin e diplomës; Evidencë 3.10_Modeli i suplementit të diplomës</b> ).
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti merr një kopje zyrtare të plotë të programit të studimit të zhvilluar, sikurse dhe plan programet e plota sipas kërkesës së tij ( <b>Evidencë Takimi me studentët e programit të studimit; Takimi me Sekretarinë Mësimore</b> ).
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve, që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databazën e Sekretarisë Mësimore, si dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria Mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentet e çdo studenti që është i regjistruar, është çregjistruar, si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre ( <b>Evidencë 2.9_Rregullore e sekretarisë mësimore</b> ).




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, mblidhen dhe përditësohen nga Dega e Burimeve Njerëzore (njësi në nivel Fakulteti) dhe Departamenti. Këto të dhëna përfshijnë personelin akademik (PAE dhe PAK), sikurse dhe personelin administrativ. Dega e Burimeve Njerëzore ruan kopjet e dokumentacionit, ndërsa dokumentet origjinale ose të noterizuara mblidhen në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (njësi në nivel universiteti) (<b>Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi, sikurse dhe me aktet e brendshme rregullatore. Procedura e rekrutimit të personelit të ri akademik kalon në disa faza:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti shprehet me vendim, të miratuar në mbledhjen e njësisë bazë, për përcaktimin e kriterëve të veçanta të punësimit, bazuar në nevojat aktuale që ka njësia bazë (në numër dhe në kategori);</li> <li>• Vendimi i Departamentit i përcillet Rektorit nëpërmjet drejtuesit të njësisë kryesore;</li> <li>• Rektori shqyrton kërkesën dhe përcjell pranë njësisë bazë, miratimin e kriterëve dhe autorizon vazhdimin e procedurave të konkursit</li> </ul>



	<p>publik;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtuesi i njësisë kryesore bën shpalljen e konkursit publik në APP dhe në faqen zyrtare të njësisë;</li> <li>• Drejtuesi i njësisë krijon komisionin ad hoc;</li> <li>• Komisioni është përgjegjës për të gjitha fazat e procesit, nga shyrtimi i dokumentacionit paraprak e deri tek paraqitja e kandidaturës fituese Rektorit të UT, nëpërmjet drejtuesit të njësisë kryesore;</li> <li>• Rektori ka të drejtë të nënshkruajë kontratën e punës, ose të anultojë konkursin në rastet kur vëren parregulsi në procedurë.</li> </ul> <p><b>(Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS; Evidencë 1.12_Manuali për punësimin e personelit UT)</b></p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Procedura dhe kriteret e posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, janë të parashikuara në aktet e brendshme rregullatore dhe bëhen publike <b>(Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS; Evidencë 1.12_Manuali për punësimin e personelit UT).</b></p> <p>Kriteret specifike, sikurse ato të përgjithshme, përcaktohen në vendimin e Departamentit, bazuar në nevojat që ka njësia bazë, sipas procedurave të shpjeguara në kriterin e mësipërm.</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Manuali për punësimin e personelit të UT, sipas kategorive të ndryshme, ka shërbyer për standardizimin e praktikës dhe procedurës së rekrutimit dhe vlerësimit, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike. Manuali përcakton fazat e veprimit dhe krijon kornizën ligjore për punësimet, duke e bërë këtë proces më transparent dhe të bazuar më shumë në meritën dhe aftësinë e kandidatëve konkurrues <b>(Evidencë 1.12_Manuali për punësimin e personelit UT).</b></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë, sikurse dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion <b>(Evidencë_Takimi me Drejtuesin e Departamentit; Takimi me GVB; Takimi me personelin akademik)</b>, konstatohet se institucioni është i angazhuar për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e</p>



<p>personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Krijimi i mjedisit dhe kushteve nis nga infrastruktura fizike në dispozicion (zyrat, pajisjet IT, kushtet e auditorëve ku zhvillohen procese akademike) (<b>Evidencë 4.13_ Të dhëna për infrastrukturën</b>), për të vijuar me një kuadër të brendshëm rregullator, publik dhe transparent, të të drejtave dhe detyrimeve të personelit (<b>Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS</b>), e deri tek mbështetja institucionale për zhvillimin e personelit (<b>Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Mbështetja e institucionit për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional të personelit akademik, përbën një ndër prioritetet e institucionit. Kjo mbështetje lidhet me mbështetjen financiare për kërkimin shkencor, mundësinë e shfrytëzimit të rrjetit të partnerëve bashkëpunues sikurse dhe mobilitetin e stafit akademik (<b>Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT; Evidencë 2.19_Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit; Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik</b>). Ndër aktivitetet kryesore, përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Konferencat dhe simpoziumet e organizuara nga Departamenti i Filozofisë, si: “Ekzistenca, Liria dhe të Menduarit në Kohë Pandemie”, “Etika fuqizon arsimin cilësor dhe demokracinë në edukim”, “Universiteti dhe Filozofia përballë modeleve të zhvillimit të sotëm botëror”, “Roli i filozofisë në transformimin e njerëzores”;</li> <li>• Mbështetja institucionale për pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete shencore të organizuara në IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit;</li> <li>• Mbështetja për botimet e personelit akademik.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Organizimi i trajnimeve për personelin akademik, organizimi i konferencave dhe mundësia për të botuar në revistën shkencore të universitetit, mundësia për mobilitetin e stafit akademik, sikurse dhe mbështetja financiare për kërkimin shkencor, janë tregues të mbështetjes për kualifikimin e personelit akademik (<b>Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT; Evidencë 2.19_Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit; Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Angazhimi në vitin akademik 2021-2022 i një personeli akademik prej 6 PAE (1 Prof. As., dhe 5 Dr., dhe 13 PAK (1 Prof., 4 Dr., dhe 8 Msc) (<b>Evidencë 4.6 gjatë vizitës Personeli akademik</b>), të cilët kanë eksperiencë dhe ekspertizë në lëndët ku ata janë të angazhuar, të mbështetur dhe nga strukturat administrative, dëshmon se institucioni ka arritur pjesërisht të mundësojë një angazhim të kënaqshëm të burimeve</p>





	njerëzore në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi, por sikurse është analizuar edhe në kriteret e mësipërme, institucioni duhet të marrë masa për përmbushjen e raportit midis PAE/PAK (i cili duhet të jetë në raportet 70%/30%) sikurse dhe të angazhojë në program vetëm personel të kategorisë 'Lektor' dhe 'Profesor'. (Evidencë 2.19_Informacion për politikën e burimeve njerëzore; Evidencë 2.20_Modeli i marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik; Evidencë 4.6_Të dhënat tabelore për personelin akademik të programit të studimit; Evidencë 4.7_Të dhëna për kërkimin shkencor në kuadër të programit të studimit).		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe vëzhgimit të infrastrukturës në funksion të programit të studimit, u konstatua se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve dhe në përputhje me fushën e programit të studimit (<b>Evidencë 4.13_Të dhëna për infrastrukturën</b>). Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të programit të studimit, ka një sipërfaqe totale prej rreth 7154 m<sup>2</sup>, ku ndër mjedise kryesore mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 22 salla për leksione/seminare, me sipërfaqe 1854 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 2 salla për aktivitete promovuese, me sipërfaqe 285 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale - me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 1 sallë interneti – me sipërfaqe 45.5 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 2 salla biblioteke - me sipërfaqe 189.5 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 1 mjedis për fotokopje, me sipërfaqe 12 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 1 zyrë informacioni për studentët, me sipërfaqe 9 m<sup>2</sup>.</li> <li>• 14 nyje hidrosanitare, me sipërfaqe 51 m<sup>2</sup>.</li> </ul> <p>Edhe mjediset e dedikuara për stafin, të cilat kanë një sipërfaqe prej 823 m<sup>2</sup>, vlerësohen si të përshtatshme dhe përbëhen nga zyrat për drejtuesit (1), sekretarinë mësimore (2), departamentet dhe personelin akademik (30), financën (1), NJSBC (1), Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve (1), IT (2) dhe nyjet hidrosanitare për personelin akademik dhe administrativ (20).</p> <p>GVJ konstaton se këto mjedise, të cilat janë edhe të pajisura me</p>



	infrastrukturën IT (kompjuter, projektor, sistem audio), janë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën e programit në fushën e shkencave etike dhe lidërsip-it.		
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore janë të pajisura me pajisjet e nevojshme elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, dhe konsiderohen të përshtatshme në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit në fushën e etikës dhe lidërsip-it. Sallat janë të pajisura me kompjuter, video-projektorë, internet, sistem fonie dhe sistem kondicionimi <b>(Evidencë 4.13 _Të dhëna për infrastrukturën).</b>		
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Laboratori i IT sikurse dhe ambientet e bibliotekës konsiderohen të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit, nisur nga vetë natyra e këtij programi. Laboratori përdoret për të aksesuar informacion, për të përgatitur prezantime dhe detyra kursi, etj., ndërsa biblioteka përdoret si për aksesimin e literaturës fizike ashtu edhe asaj elektronike <b>(Evidencë 4.13 _Të dhëna për infrastrukturën).</b>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Laboratori i IT është i pajisur me programet e paketës Microsoft Office, të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij programi studimi. Për shkak të natyrës së programit të studimit, ku nevoja për programe profesionale është relativisht e kufizuar, GVJ konstaton se kapacitetet ekzistuese janë optimale për këtë program studimi. <b>(Evidencë _Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve).</b>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Nga vizita në institucion, vëzhgimi i infrastrukturës, konstatohet se institucioni garanton kapacitetet dhe mjediset e nevojshme, për zhvillimin e veprimtarive praktike (të cilat lidhen kryesisht me përgatitje prezantimesh, detyra kursi, etj.) <b>(Evidencë 4.13 _Të dhëna për infrastrukturën).</b>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>



<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka mësimore vlerësohet si e përshtatshme, si në aspektin e kapaciteteve akomoduese (poste leximi dhe kompjuter) ashtu edhe në aspektin e fondit fizik të literaturës në dispozicion. Këto elemente garantojnë mundësinë e shfrytëzimit të bibliotekës në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit ( <b>Evidencë 4.13_ Të dhëna për infrastrukturën</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Fondi i bibliotekës në dispozicion të fushës studimore të këtij programi studimi vlerësohet si i përshtatshëm ( <b>Evidencë 2.29_ Informacion për bibliotekën; Evidencë 2.30_ Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës; Evidencë 2.31_ Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS; 4.10_ Biblioteka dhe burimet e literaturës</b> ). Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Pjesë e bibliotekës janë edhe libraritë online, të tilla si UNRISD, Accueil, EuroPS Services, Springer, Sagepublications, të cilat mund të aksesohen nga ambientet e bibliotekës, si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies ( <b>Evidencë 2.29_ Informacion për bibliotekën</b> ).
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Në ambientet e bibliotekës gjenden kompjuter, të cilët janë të pajisur me paketën Microsoft Office, e cila mund të përdoret nga studentët e këtij programi studimi, pa kufizime për të gjithë studentët e interesuar ( <b>Evidencë 4.13_ Të dhëna për infrastrukturën</b> ).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Shtimi i zërave të bibliotekës është një proces periodik, bazuar mbi kërkesat e departamentit dhe personelit akademik, sipas një plani të detajuar për këtë qëllim. Përditësimi i fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit iniciohet nga personeli akademik, nisur nga nevojat e evidentuara në bazë të literaturës së nevojshme për lëndët e tyre. Kërkesa i përcillet drejtuesve të njësisë bazë/kryesore, dhe në






	bashkëpunim me Administratorin e njësisë kryesore, fillojnë procedurat për blerjen e literaturës së nevojshme ( <b>Evidencë 2.29_ Informacion për bibliotekën; Evidencë 2.30_ Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës; Evidencë 2.31_ Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS).</b>		
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve, në orarin 08:00-16:00, orar i cili është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Në sezonin e provimeve, biblioteka funksionon edhe përtej këtij orari. Nga vizita në mjediset e bibliotekës dhe zhvillimit të takimit me punonjësen e bibliotekës, konstatohet se kapacitetet ekzistuese janë të përshtatshme në raport me numrin e frekuentuesve të këtyre ambienteve ( <b>Evidencë_ Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve).</b>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<b>Gjatë vizitës në institucion, nga përfaqësuesit e sekretarisë mësimore u deklarua se institucioni ka aktualisht një sistem menaxhimi, por nuk ishte në përdorim për shkak të disa problematikave teknike.</b> Administrimi i informacionit që lidhet me studentët, proces i cili drejtohet nga sekretaria mësimore, është i pasqyruar në regjistrat specifik dhe dokumentacionin përkatës ( <b>Evidencë 2.9_Rregullore e sekretarisë mësimore).</b>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i menaxhimit të të dhënave të personelit, administrohet nga Dega e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti. Dega e Burimeve Njerëzore administrohet të dhënat e stafit (kopje të dokumentacionin) mbi kualifikimet dhe aktivitetet e tyre, kontratat e punës, CV dhe dokumentacionin shoqëruar ( <b>Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS).</b>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe	Aksesi në informacion dhe dokumentacion është i dedikuar vetëm për zyrat/personat përgjegjës. Palët e interesuara mund të aksesojnë informacionin nëpërmjet parashtrimit të kërkesave. <b>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga institucioni, por edhe nga</b>




studentët e programit të studimit.	<i>informacioni i marrë nga vizita në institucion, rezulton se aktualisht po punohet për krijimin e një sistemi informatik të dedikuar (Evidencë Takimi me Drejtuesin -e Departamentit; Takimi me Sekretarinë Mësimore; Takimi me GVB).</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Institucioni është mbështetur në përdorimin e platformës Microsoft Teams, për zhvillimin e procesit akademik gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit kryhet edhe nëpërmjet adresave të e-mailit. <i>Gjuhësi, vendosja në funksionim e platformave të integruara, është një aspekt i cili duhet të merret në konsideratë nga institucioni (Evidencë 1.10_Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT; Evidencë 1.15_Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë).</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Përveç disa faciliteteve që mundësohen nga përdorimi i platformës Microsoft Teams, <i>mungesa e platformave të integruara në një sistem menaxhimi elektronik, bën që institucioni të mos jetë në gjendje të garantojë përmbushjen e këtij kriteri.</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet e lidhura me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme, publikohen në faqen e internetit të institucionit ( <a href="http://www.unitir.edu.al">www.unitir.edu.al</a> ), në gjuhën shqipe dhe angleze.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

#### Standardi IV.6


**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni harton raportin financiar të kostove të programit dhe plani për mbështetjen financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit. <b>(Evidencë shtesë 2_Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programit të studimit).</b> Ndër dokumentet kryesor të lidhur me buxhetin, rendisim: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendimin e Dekanatit të FSHS për miratimin e buxhetit;</li> <li>• Pasqyrat në lidhje me pagat dhe bursat;</li> <li>• Pasqyrat në lidhje me të ardhurat e kushtëzuara;</li> <li>• Pasqyrat në lidhje me numrin e punonjësve;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pasqyrat në lidhje me numrin e studentëve;</li> <li>• Regjistri i parashikimit të prokurimeve publike;</li> <li>• Pasqyrat në lidhje me investimet.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit përmban zërat e ndryshëm, si kostot dhe shpenzimet ashtu edhe të ardhurat. Të gjithë zërat bëhen bazuar në nevojat e njësive bazë dhe njësive kryesore, nga personeli akademik, tek infrastruktura, mbështetja financiare për kërkimin shkencor, etj. (<b>Evidencë shtesë 2_Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programit të studimit</b>). Në dokumentacionin mbi buxhetin, paraqiten elementët e lidhur me financimin e burimeve njerëzore, si për personelin akademik ashtu edhe për atë administrativ, shpenzimet operative për infrastrukturën (mirëmbajtjen dhe përmirësimin e saj), sikurse dhe shpenzimet për pasurimin e fondit të bibliotekës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Universiteti i Tiranës, si një institucion publik i arsimit të lartë, i nënshtrohet të gjitha detyrimeve, sipas parashikimeve ligjore në fuqi (<b>Evidencë shtesë 2_Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programit të studimit</b>). Në dokumentacionin e përcjell nga IAL lidhur me buxhetin, pasqyrohet edhe raporti financiar në të cilin paraqiten të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni dokumenton raportet financiare për vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin e financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij (<b>Evidencë shtesë 2_Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programit të studimit</b>). Raportet financiare përfshijnë kostot e lidhura me pagesat për personelin akademik dhe administrativ, burimet e financimit dhe tarifat e studimeve, sikurse dhe shpenzimet operative lidhur me mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e institucionit, konstatohet se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit</p>





përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<b>(Evidencë shtesë 2_Dokumente të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programit të studimit).</b> Qëndrueshmëria financiare garantohet si nga të ardhurat nga tarifat e studentëve ashtu edhe nga mbështetja nga buxheti, duke qenë se IAL përgjegjëse për programin e studimit, është IAL publike dhe financohet edhe nga buxheti i shtetit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UT zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, Statutin dhe Rregulloret e UT ( <b>Evidencë 1.2, Neni 87,88,89_Statuti i UT; Evidencë 1.3. Neni 31, 32,33; Rregullore e UT; Evidencë 2.4. Neni 21, 22, Rregullore e FSHS</b> ). Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mësimore dhe biseda me studentët, GVJ konstaton se, institucioni respekton legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Informacioni mbi këto procedura publikohet në web-in zyrtar të UT dhe FSHS-së dhe sqarohet në institucion për çdo të interesuar.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni zbaton politika dhe procedura të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomim të tij. ( <b>Evidencë 2.4._ Rregullore e FSHS</b> ).
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të	Senati Akademik i UT, përpara fillimit të vitit të ri akademik, publikon në faqen zyrtare kriteret për përzgjedhjen e studentëve kandidatë në programet e nivelit të dytë Master i Shkencave, kriteret të përcaktuara në përputhje me Statutin e UT ( <b>Evidencë 1.2, neni 91,94_Statuti i UT;</b>



<p>transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p><b>Evidencë 3.6, Kreu V, Neni 28, 29, 30-Kriteret e pranimit).</b> Në fillim të vitit akademik, strukturat e IAL-së, (fakulteti dhe njësia bazë përgjegjëse), ofron për kandidatët për studentë, mundësinë për të aksesuar kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit (<b>Evidencë 4.1_ Korniza Konceptuale e programit të studimit, pika 5. Kushtet e pranimit; Kriteret e pranimit, fq. 5</b>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve është i përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit</b>). Kriteret e përgjithshme për pranimin në këtë program studimi janë: mbrojtja e gjuhës së huaj (niveli B1) dhe përfundimi i ciklit të parë. Për të ndjekur Programin e studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, studenti duhet të ketë përfituar një diplomë të ciklit të parë Bachelor dhe ka grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Çdo kandidat është i detyruar të plotësojë këto kriteret:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve (minimumi 3 vjet) të përputhshme në masën 60 % me trungun e lëndëve të ciklit të dytë (Master i Shkencave);</li> <li>• Diplomë e arsimit të lartë e përfutur jashtë vendit e vlerësuar ekuivalente me diplomat e mësipërme sipas kuadrit ligjor në fuqi.</li> <li>• Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë;</li> <li>• Institucionet e arsimit të lartë mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”, me qëllim transferimin e tyre, në programet e studimit “Master i Shkencave”.</li> </ul> <p>Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, studentët e regjistruar në programet e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” kanë detyrim ligjor njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (<b>Neni 76, pika 4, Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</b>).</p> <p>Në fund dhe fillim të çdo viti akademik, Institucioni vlerëson ndikimin e politikave aktuale të pranimit për studentët në të gjitha programet e studimeve, e konkretisht për programin Master i Shkencave, një nga kriteret pranuese është përputhshmëria në masën 60 % me trungun e lëndëve të ciklit të dytë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>Informimi dhe orientimi për kandidatët për studentë apo për një publik më të gjerë, lidhur me kërkesat apo kriteret e përgjithshme e specifike, realizohet në disa forma si në takimet informuese në institucion me pedagogë të këtij departamenti; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj. (<b>Evidencë 3.16_Politikat e Marketingut për programin e</b></p>



përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<b>Studimit)</b>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, por edhe takimeve në sekretarinë mësimore, GVJ konstaton se kandidatëve, që në fazën e parë të aplikimit, u ofrohet informacion lidhur me programin e studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidership”, ku përfshihen: plani mësimor (kurrikula), stafi akademik, koha e realizimit, koha e përgatitjes dhe e mbrojtjes së diplomës (provimit të përgjithshëm përfundimtar/mbrojtjes së tezës) ( <b>Evidencë 3.6, Neni 15-22_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 4.2_Plani mësimor i programit të studimit</b> ). Studentët e regjistruar në këtë program, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me stafin akademik, koordinatorin e programit të studimit dhe përgjegjësin e departamentit mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik. Gjithashtu, studentët u shprehën se marrin informacion të vazhdueshëm nga pedagogu/ët e lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet përgjatë semestrit: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, si edhe nga koordinatori i programit. Studentët informohen në lidhje me kurset e detyrueshme dhe me zgjedhje, praktikën profesionale dhe temën e diplomës ( <b>Takimet në institucion</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Departamenti i Filozofisë ndjek dhe harton procedura mbi njohjen e transferimet e krediteve dhe mobilitetin, i bazuar tek realizimi i procedurës dhe informimit të studentëve mbi këto procese. ( <b>Evidencë 1.2, Neni 109_Statuti i UT; Evidencë 2.4, Neni 50_Rregullore e FSHS</b> ). Në rastet e transferimit të studimeve, dosja e kandidatit shqyrtohet nga një komision ad hoc, në përputhje me rregulloren e programit të studimit. ( <b>Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit</b> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve të parashikuara në Kreun III të Rregullores së Programit të Studimit, nenet 13, 14, ku janë përcaktuar mënyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve, e drejta për të hyrë në provim pasi studenti ka ndjekur mjaftueshëm orët e leksioneve dhe seminareve, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimit. Kriteret dhe procedurat e




	<p>vlerësimet parashikohen në programet e lëndëve, duke ju dhënë atyre mundësi të plotësojnë njohuritë dhe sqarojnë paqartësitë gjatë dhe në fund të procesit mësimor (<b>Evidencë 4.3_Programet mësimore të lëndëve; Evidencë 3.6 Kreu IV. Neni 23; Evidencë 4.1, pika 6_Korniza konceptuale e programit të studimit</b>), si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar;</li> <li>• me detyra kursi, projekte, poster;</li> <li>• i bazuar në një shumë llojshmëri formash vlerësimi.</li> </ul> <p>Format e kontrollit të vazhdueshëm të studentit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrje aktive në diskutime rreth tematikave gjatë zhvillimit të seminareve dhe aftësitë e shkathtësia për punën e pavarur në grup me 20% të lëndës;</li> <li>• Detyrë kursi me 20% të lëndës;</li> <li>• Provimi përfundimtar është provimi me shkrim që zhvillohet në fund të semestrit dhe përbën 60% të vlerësimit semestral të lëndës.</li> </ul> <p>Vlerësimet e ndërmjetme u komunikohen studentëve para hyrjes në provim. Krahas rregullores, çdo pedagog në orën e parë të zhvillimit të lëndës, prezanton programin dhe u bën me dije studentëve format e vlerësimit të dijeve e aftësive, sikurse doli edhe nga diskutimi me stafin akademik të programit të studimit dhe studentët e këtij programi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik, DF informon studentët e regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidership” mbi procedurat e diplomimit, bazuar kjo edhe në rregulloren e programit të studimit (<b>Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit, Neni 22, Punimi i diplomës</b>). Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga stafi akademik dhe drejtues, dhe u konfirmua nga studentët që ky informacion ju ishte dhënë studentëve që në fillim të vitit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të. Kryesisht studentët i përkasin programit të studimit Bachelor në Filozofi i ofruar nga Departamenti i Filozofisë, por edhe nga disiplina të ngjashme. Departamenti i Filozofisë, shfrytëzon platforma sociale si instagram, facebook, si dhe faqen elektronike të fakultetit si më poshtë:  <i>e-mail: <a href="mailto:fshs.ut.info@gmail.com">fshs.ut.info@gmail.com</a></i>  <i>instagram: Departamenti i Filozofisë/Info.fshs</i>  <i>facebook:Fakulteti i Shkencave Sociale/Studentët-Departamenti i Filozofisë.</i></p> <p>Përveç informacioneve online, departamenti përgatit dhe shpërndan broshura të pasuar me informacionin e nevojshëm për çdo shtresë dhe grup moshë (<b>Evidencë 4.20_Guida studentore</b>).  Gjithashtu koordinatori i programit të studimit, t në bashkëpunim me</p>







	strukturat përgjegjëse, merr pjesë në organizimin e veprimtarive të informimit për maturantët kandidatë që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit ( <b>Evidencë 3.12_Përshkrimi i veprimtarisë së koordinatorit të programit të studimit</b> ). Për informimin e studentëve mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të kujdeset dhe shërbimi i karrierës ( <b>web zyrtar <a href="https://fshs-ut.edu.al/">https://fshs-ut.edu.al/</a> i UT, FSHS_Shërbimi i Karrierës në FSHS</b> ).		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informacioni lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, ofrohet nga Departamenti i Filozofisë si njësi bazë, që nga momenti që studenti fillon studimet. Fakulteti i Shkencave Sociale, nëpërmjet strukturave të veta, departament, staf akademik, koordinatori programi dhe sekretari mësimore, siguron menaxhim të informacionit në lidhje me programin e studimit. Si një kanal i rëndësishëm i komunikimit dhe informimit është dhe faqja eeb e Fakultetit, ku është i detajuar programi që po analizojmë, si: kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Master i Shkencave “Etika në institucione dhe lidhshmëri”, i cili është 2 vite akademike, e që u përkojnë 120 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë. Edhe nga takimi me studentet u vu re se ata ishin të mirë informuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe organizimin e programit të tyre. ( <b>Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit; Vizita në Institucioni, takimi me studentët e këtij programi studimi</b> )
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e programit të studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidhshmëri” informohen në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit nëpërmjet koordinatorit të programit dhe pedagogëve përkatës ( <b>Evidencë 4.2_Plani mësimor i programit të studimit</b> ). Në fillim të vitit të ri akademik dhe çdo fillim semestri, studentëve u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës programi i lëndës/ve ( <b>Evidencë shtesë_Programe 21-22</b> ), ku janë specifikuar temat me literaturën e detajuar, format e vlerësimit të dijeve, etj. Gjithashtu, studentët kanë një manual siç është Guida Studentore ( <b>Evidencë 4.20</b> )
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon	Institucioni përmes Shërbimit të Karrierës, Alumnit dhe Departamentit






<p>studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm (CV, letër motivimi, letër rekomandimi etj.) përmes aktivitete këshilluese të organizuara në mënyrë periodike (<b>Evidencë 2.25_Rregullore e shërbimit të karrierës; Evidencë 4.19_Aktivitet e departamentit; Takime me studentë dhe ALUMNI</b>). Institucioni ka krijuar një traditë me panairt e punës me rrjetin e bashkëpunëtorëve me të cilët ndërmjetëson edhe për praktikant profesional, të cilat janë porta e parë e orientimit në tregun e punës. (<b>Evidencë 4.15. Tabela përmbledhëse për trajnimet profesionale të studentëve të diplomuar; Evidencë 2.25_Dokumenti mbi funksionimin e Zyrës së Shërbimit të Karrierës; ëeb zyrtar <a href="https://fshs-ut.edu.al/">https://fshs-ut.edu.al/</a></b>). ZSHK-ja ofron të gjitha llojet e shërbimeve dhe kujdesit ndaj studentëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- orientim për karrierën;</li> <li>- këshillim për karrierën;</li> <li>- informim dhe asistencë për aplikim për programet e studimit;</li> <li>- informim dhe orientim për tregun e punës.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në funksion të realizimit të procesit mësimor, koordinatori e programit të studimit, e cila koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e këtij programi, për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij, së bashku me sekretarinë mësimore dhe personelin akademik dhe ndihmës akademik, u venë në dispozicion studentëve informacion të përditësuar mbi gjithë komponentët e zhvillimit dhe organizimit të procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet, si nëpërmjet komunikimeve elektronike, nëpërmjet e-mail-it zyrtar, ashtu dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me ta (<b>Takimet në institucion, vizita në sekretarinë mësimore të programit të studimit; Evidencë 2.9_Rregullore e sekretarisë mësimore; Evidencë 3.6_Rregullore e programit të studimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Strukturat brenda Fakultetit të Shkencave Sociale, si dhe njësi përgjegjëse e programit të studimit, ofrojnë informacionin e nevojshëm për studentët e interesuar. Gjithashtu institucioni disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit për studentë, qofshin edhe në distancë duke ju mundësuar informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët sipas viteve dhe semestrave, kreditet, rezultatet e marra (notat) etj. Personeli akademik dhe studentët e këtij programi studimi përdorin platformën Microsoft Teams, e cila gjeti zbatim të gjerë gjatë pandemisë Covid-19 (<b>Evidencë 1.15_Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë; Evidencë 1.17_Për disa shtesa në udhëzuesin UT për zhvillimin e mësimit në distancë; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS; Evidencë 3.3_Rregullore e Departamentit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron</p>	<p>Departamenti i Filozofisë nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti komunikimi mes studentëve dhe personelit akademik dhe ndihmës akademik, ka</p>



informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve.	siguruar menaxhim dhe administrim cilësor të çdo aktiviteti mësimor dhe jo vetëm të studentëve të tij. (Takime në institucion dhe dokumentacion i venë në dispozicion gjatë këtyre takimeve)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përfshirë pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e studimit.	Gjatë takimeve në Sekretarinë Mësimore, GVJ-së iu vunë në dispozicion të dhëna lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip”. Institucioni disponon dhe ka një sistem të menaxhimit të të dhënave të studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat e tyre nga regjistrimi deri në diplomim. Kjo mundëson realizimin nga ana e personave të autorizuar, të raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve ( <b>Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore; Evidencë 2.9. Neni 5_Rregullore e sekretarisë mësimore; Evidencë 4.8, Tab 21, 23_Të dhëna për regjistrimin, ecurinë, diplomimin dhe punësimin e studentëve</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Institucioni mban rregullisht statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit. Ky numër përfshin transferimet nga programe paralele brenda IAL-së apo IAL të tjera brenda vendit, tërheqjen nga programi i studimit ( <b>Evidencë 2.9_Rregullore e sekretarisë mësimore; Evidencë 4.8, tab. 21_Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve</b> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit venë në dispozicion, takimeve në sekretarinë mësimore dhe koordinatorin e programit, ( <b>Evidencë 2.9_Rregullore e sekretarisë mësimore</b> ), GVJ konstaton se institucioni administron në mënyrë permanente dosjet e çdo studenti me të gjitha të dhënat e tij/saj që nga momenti i regjistrimit në këtë program studimi e deri në finalizim të tij (diplomim) që përbën njëkohësisht indikatorin dhe finalitetin e dimensionit shkencor të Masterit të Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, duke u shpalosur si sintezë e dy viteve





	studimi të thelluar në etikën, institucionet dhe lidhshimin institucional.		
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni disponon dhe ka një sistem të menaxhimit të të dhënave të studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Kjo mundëson realizimin nga ana e personave të autorizuar, të raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve ( <b>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë; Evidencë 2.9. Neni 5_Rregullore e sekretarisë mësimore</b> ).		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Institucioni harton raporte me të dhëna analitike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe ndjek punësimin e tyre përmes njësisë bazë dhe atyre mbështetëse, si ZKK, Alumni-t etj. Sipas të dhënave në <b>evidencën 4.8, tabela 21 “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve”</b> , në brezin e parë të studentëve në programin Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidhshimin” në vitin akademik 2019–2020 janë regjistruar 31 studentë dhe në vitin akademik 2020-2021 janë regjistruar 46 studentë. Numri total i të diplomuarve është 76, prej të cilëve 56 janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 20 janë të punësuar jo në përputhje me diplomën. Ndërsa, sipas të dhënave në ( <b>Evidencën 4.14_ Të dhëna për punësimin real të studentëve (tabelat 4-6)</b> , në vitin 2019, nga 26 studentë të diplomuar, paraqiten 24 studentë të punësuar ose 92.3% (2 studentë janë larguar jashtë) nga të cilët 9 prej tyre janë të punësuar brenda profilit; në vitin 2020, nga 18 studentë të diplomuar, paraqiten 17 të punësuar ose 94.4% (1 student i larguar jashtë), dhe 11 studentë të punësuar brenda profilit; në vitin 2021, nga 27 studentë të diplomuar, paraqiten 23 studentë të punësuar ose 85.2%, nga të cilët 11 janë të punësuar brenda profilit ( <b>Evidencë 4.8 Tab 21_Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, Master i Shkencave “Etika në institucione dhe lidhshimin”, tab 23_Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve të këtij programi studimi</b> )		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre	Në Statutin e Universitetit të Tiranës janë parashikuar përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse si në Senatën Akademik, në Këshillin e Etikës, në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë, me përjashtim të rasteve të




<p>në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>parashikuara në legjislacionin në fuqi. (<b>Evidencë 1.2, Neni 30, pika 3_Senati Akademik, Neni 40_Komisioni mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Neni 42_Komisioni i përhershëm i kurrikulës; Neni 43_Këshilli i Etikës; Neni 125_Të drejtat e studentëve</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Angazhimi i studentëve është konkret, pasi ata janë vendimmarrës në disa struktura të universitetit. Të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies përmes Njesisë e Sigurimit të Cilësisë, bëhen pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës. Rezultatet e këtyre instrumenteve trajtohen në nivel të strukturave drejtuese. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje garantohej përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse, sikurse u shtjellua në Kriterin 1 më sipër. Po ashtu, vlerësimi i tyre mbi procesin akademik dhe performancës së stafit akademik kryhet edhe nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve në fund të semestrit ose përpara fillimit të sesionit të provimeve për të marrë vlerësimet e tyre, të cilat pasi diskutohen në departament pasqyrohen në analizat dhe raportet periodike (<b>Evidencë 3.18_Raport Vjetor</b>). Institucioni ka miratuar një paketë instrumentesh të cilësisë (<b>Evidencë 1.14</b>). Pjesë e GVB-së për akreditimin e programit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidership” është edhe një përfaqësues i studentëve, i cili u takua nga GVJ edhe gjatë vizitës (<b>Evidencë 2.17_Të dhëna tabelore për njësitë, studentët e angazhuar në SBC në nivel FSHS; Vendimi i dekanit për emrat e anëtarëve të GVB-së</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni ka unifikuar kurrikulat, duke respektuar kuadrin ligjor dhe në këtë mënyre edhe ngarkesën e studentëve. Lëndët që zhvillohen në programin e studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidership” janë të klasifikuara në bazë të rëndësisë që kanë në formimin e studentit dhe realizimit të fokusit të çdo semestri dhe viti akademik. Organizimi i planit mësimor është bërë në bazë të Sistemit të Bolonjës. Programi i studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidership” është i organizuar në 120 ECTS, 2 vite akademike, 4 semestra, me një shpërndarje të balancuar të ngarkesës të shprehur në kreditë ECTS (<b>Evidencë shitesë 3_Plani mësimor i programit të studimit</b>), në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Duke iu referuar kornizës ligjore, një kredit (ECTS) korrespondon me 25 orë pune të një studenti dhe sasia mesatare e punës së përfunduar gjatë një viti të studimeve për një student është 60 (gjashtëdhjetë) ECTS ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë të orarit të punës së studentëve, i cili përfshin orë në auditor dhe orë të punës së pavarur. Përmirësimet e programit të studimit lidhen si me përditësimin e syllabuseve ashtu edhe me përditësimin e programit të studimit në tërësi. Programi i studimit Master i Shkencave, ka pësuar disa ndryshime nën masën 20%.</p>






	(Evidencë 2.16_Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit; Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit; Evidencë 3.15_Procedurë e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës). Institucioni lehtëson njohjen e lëndëve që janë të transferueshme në rastet kur studentët vijnë nga jashtë shtetit ose nga IAL të tjera (Evidencë 1.2, Neni 109 Transferimet_Statuti UT; Evidencë 1.3, Kreu III, Neni 78,79).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Institucioni, përmes pyetësorëve të studentëve që realizohen çdo fund semestri apo përpara fillimit të sesioneve të provimeve, dy herë në vit, me secilin grup, për të gjitha lëndët dhe pedagogët, si dhe për planet mësimore të lëndëve (syllabuset) (Evidencë 1.13_Manuali i performancës së stafit akademik; Evidencë 3.6, Neni 31, Kreu V_Rregullore e Programit të studimit), garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Në kuadër të akreditimit të programit të studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, Institucioni ka përfshirë në grupin e punës edhe përfaqësues të studentëve për të punuar dhe dhënë kontribut në hartimin e RVB-së (Evidencë 2.17_ Të dhëna tabelore për njësitë, studentët e angazhuar në SBC në nivel FSHS. Vendimi i dekanit për emrat e anëtarëve të GVB-së).			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	Rregullorja e UT përcakton procedura në rast ankese nga studenti. Studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pa llogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim te Përgjegjësi i departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit. (Evidencë 1.3, Neni 50,51_Rregullore e UT; Evidencë 2.27_Informacion për bazën rregullatore të ankimit të studentëve). Institucioni nëpërmjet NjSBC-së përdor metoda të drejtpërdrejta dhe mjete të tërthorta vlerësimi, ku studentët kanë mundësi të shprehin mendimin, vlerësimin dhe kërkesat e tyre duke plotësuar formularët, ku vlerësojnë pedagogun, lëndën, stafin administrativ, etj. Të cilët realizohen në javën e fundit të çdo semestri (Evidencë 1.13_Manuali i performancës së stafit akademik)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	



**Standardi V.6**

**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.

Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi, zotëron kualifikime të ndryshme për specialitetin e lëndës që ofron. Ata vijnë nga një përvojë e gjatë profesionale në fushën e mësimdhënies, por edhe në drejtimet profesionale që ata përfaqësojnë (**Evidencë 4.16\_CV staf akademik**). Veprimtaria kërkimore – shkencore e personelit akademik priret të organizohet e zhvillohet në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të UT-së dhe Strategjisë së Institucionit (**Evidencë 1.2; Evidencë 1.4, Pika 3. Kërkimi shkencor**). Tregues të veprimtarisë kërkimore janë veprimtaritë e ndryshme kërkimore si: konferencat shkencore, botimet në revista, kërkimet në bashkëpunim me institute apo agjenci kërkimore brenda dhe jashtë vendit, udhëheqjet e doktoratave brenda dhe jashtë universitetit, etj. Udhëheqjet e punimeve të studentëve të programeve Master janë pjesë e cilësisë së stafit pedagogjik kërkimor (**Evidencë 4.7\_Të dhëna të plota për kërkimin shkencor; Evidencë 4.11\_Të dhëna për aktivitetet dhe kualifikimin e stafit**).

**Kriteri 2.** Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.

Fokusi dhe angazhimi kryesor i Departamentit të Filozofisë është përfshirja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare (**Evidencë 3.5\_Strategjia e programit të studimit**), kjo si përmes pjesëmarrjes në rang individual të stafit akademik, ashtu edhe përmes aplikimit në rang Institucioni për bashkëpunime në projekte si: Erasmus + Horizon 2020 etj. Për realizimin e programit të studimit, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda vendit. Më konkretisht, marrëveshjet e bashkëpunimit me disa universitete brenda vendit si Universiteti “Marin Barleti”, Instituti i Antropologjisë Kulturore, etj. të cilat iu adresohen studentëve të programeve të studimit që ofron Departamenti i Filozofisë (**Evidencë 3.17\_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit**).

*GVJ konstaton se institucioni disponon një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi, rreth 19 të tilla, këto edhe sipas specifikave që kanë programet e studimit, por disa nga këto marrëveshje duhet të rifreskohen dhe shtohen. Veçanërisht me vlerë do të ishte rritja e bashkëpunimit me institucione akademike jashtë vendit, veçanërisht me institucione prestigjioze të vendeve të Bashkimit European apo me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.*

**Kriteri 3.** Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.

Personeli akademik tregon një angazhim maksimal për përfshirjen dhe motivimin e studentëve duke nisur nga shkrimi i detyrave të kursit, sikurse dhe puna në grup apo individuale për seminarët në lëndë të ndryshme, organizimi i konferencave, trajnimeve dhe leksioneve të



	<p>hapura, ku studentët janë të ftuar të marrin pjesë, janë tregues të mbështetjes në aspektin organizativ, si: Konferenca shkencore ndërkombëtare “Elitat me mendim dhe platforma idesh, jeta mendonjëse dhe debati për projektimin e shqiptarit dhe Shqipërisë në prosperitet”, ku referuan 6 studentë; Workshopi “Universiteti dhe filozofia përballë modeleve të zhvillimit të sotëm botëror”, ku kanë referuar 3 studentë, etj. (Evidencë 2.24_Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studentëve; 3.17_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidencë 4.7_Të dhënat e plota për kërkimin shkencor në kuadër të programit të studimit). Ky element u konstatua edhe gjatë takimit me studentët e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Punimet shkencore dhe botimet e personelit akademik janë të pasqyruara në bazën e të dhënave që disponon departamenti, i cili i përditëson në vijimësi (Evidencë 4.7_Të dhënat e plota për kërkimin shkencor në kuadër të programit të studimit). Organizimi i trajnimeve për personelin akademik, organizimi i konferencave dhe mundësia për të botuar në revistën shkencore të universitetit, mundësia për mobilitetin e stafit akademik, sikurse dhe mbështetja financiare për kërkimin shkencor, janë tregues të mbështetjes për kualifikimin e personelit akademik. (Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT; Evidencë 2.19_Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit; Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p><i>Përfshirja e studentëve evidentohet në kërkimin shkencor të pedagogëve dhe pjesëmarrjen në konferenca, por nuk konstatohen raste të angazhimit të tyre në studime inovative apo patentave.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Realizimi i provimit përfundimtar (diplomim) që përbën njëkohësisht indikatorin dhe finalitetin e dimensionit shkencor të Masterit të Shkencave “Etika në institucione dhe lidhshmëri”, duke u shpallur si sintezë e dy viteve studimi të thelluar në etikën, institucionet dhe lidhshmërinë institucionale, garantohej nga personeli akademik (pedagogu udhëheqës) se punimi është realizuar sipas standardeve shkencore dhe përmbush kriteret institucionale për kërkimin shkencor (Evidencë 2.11_Rregullore e diplomimit; Evidencë 4.5_Paketa e punimit të diplomës). Përgatitja e punimit kryhet sipas një plani të dakordësuar ndërmjet udhëheqësit shkencor dhe studentit. Personeli akademik i cili mentoron studentët dhe është në mbështetje të tyre, shfrytëzon dhe institucionet e praktikave, ku 20% e tyre kanë zhvilluar temën e diplomës, e ku këto institucione kontribuojnë për realizimin e analizave dhe matjeve deri në përpunimin e të dhënave. (Evidencë 3.19_Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit).</p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi V.7



**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UT ka implementuar procesin e ndërkombëtarizimit dhe mobilitetit, duke zgjeruar rrjetin ndërkombëtar të kërkimit shkencor dhe rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik (<b>Evidencë 1.4_Strategjia e UT</b>). Institucioni ndjek politika integruese lidhur me dimensionin ndërkombëtar në të gjitha kurrikulat e saj. (<b>Evidencë 2.3_Strategjia e zhvillimit të FSHS; Evidencë 3.2_Strategjia e programit të studimit</b>). <i>GVJ sugjeron se promovimi dhe mbështetja që ju jepet studentëve, në periudha afatshkurtra për të studiuar në universitete partnere, apo ofrimi i mundësive për personelin akademik për të marrë pjesë në veprimtari dhe aktivitete ndërkombëtare, duhet të intensifikohet.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Filozofisë, nëpërmjet implementimit të metodave të kërkimit nga personeli akademik, është i angazhuar të pajisë studentët me aftësitë që u nevojiten për tu marrë me çështje bashkëkohore, trajnim akademik të avancuar, dhe të nxisë kërkimin në nivelin më të lartë duke i përgatitur ata për ciklin e tretë të studimit. Programi i studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip” i përgatit studentët për të qenë në gjendje të specializohen në një fushë të caktuar të zgjedhur prej tyre, gjatë studimeve në këtë program. Studentët marrin lëndë të specializuara në fusha si e drejtë administrative, etika në administratë dhe biznes, lidërsipi dhe standardet si dhe fusha të tjera, që i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësi të avancuara dhe kompetenca për pranimin në ciklin e tretë të studimeve doktorale (<b>Evidencë 4.2_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë 3.6, Kreu II, III_Rregullore e programit të studimit</b>). <i>Sikurse analizuar edhe më lart, GVJ rekomandon të shihet me prioritet përfshirja e lëndës së metodave të kërkimit shkencor në kategorinë A, për ta ndihmuar studentët për një kalim dhe angazhim sa më cilësor në Ciklin e III të studimeve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Në prioritetet strategjike të DF është inkurajimi i studentëve për tu përfshirë në projekte të ndryshme kërkimore vendase dhe të huaja. (<b>Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit; Evidencë 3.18_Rraport vjetor</b>). Studentët e DF, pjesë e së cilës janë dhe studentët e programit master i shkencave, kanë marrë pjesë në projekte shkencore të realizuara nga departamenti si më poshtë:</p>





	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konferenca shkencore ndërkombëtare me temë “Elitat me mendim dhe platformë idesh”;</li> <li>• Workshop “Universiteti dhe filozofia përballë modeleve të zhvillimit të sotëm botëror”;</li> <li>• Auditor i hapur “Filozofia e integritetit evropian”;</li> <li>• Etj.</li> </ul> <p><b>(Evidencë 4.7_ Të dhëna të plota për kërkimin shkencor; Evidencë 4.19_ Dosja e leksioneve, aktivitetet e departamentit).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Në përmbushje të misionit të tij, Departamenti i Filozofisë nëpërmjet bashkëpunimeve me partnerë në aktivitete shkencore me pjesëmarrje të lektorëve të huaj apo të diasporës, ka zhvilluar disa të tilla, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Konferenca me titull “Lidershipi dhe zhvillimet sociale” me lektore Prof.Asc. E.Se &amp; Prof.Asoc. M.M;</li> <li>• Konferenca Shkencore Bndërkombëtare me temë” Elitat me mendim dhe platforma idesh,.... me lektore Prof.Asc. S.P, Prof. F.C;</li> <li>• Leksion i hapur: “1968 Revolucioni kulturor ne bazë të shoqërisë perëndimore aktuale” paraqitur nga Profesor C. L.R;</li> <li>• Etj.</li> </ul> <p><b>(Evidencë 4.7, Kreu III, Aktivitete shkencore dhe mësimore me pjesëmarrje të lektorëve të huaj_ Të dhëna të plota të aktiviteteve kërkimore)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Nga diskutimet me studentë të programit të studimit, sikurse dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, GVJ konstaton se institucioni mbështet me politika favorizuese studentët e këtij programi studimi duke ju mundësuar ndjekjen e disa moduleve për një afat të shkurtër kohor. Strukturat të cilat ndjekin gjithë procedurat nga informimi dhe deri në përmbyllje të një semestri për studentët e mobilitetit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sektori i Mrrëdhënive me Jashtë</li> <li>• Dekani i FSHS</li> <li>• Dega e shërbimeve për studentët e FSHS</li> <li>• Koordinatori i FSHS për mobilitet</li> <li>• Sekretaria mësimore</li> <li>• Dega e burimeve njerëzore</li> <li>• Dega e financës dhe buxhetit <b>(Evidencë 4.7, Kreu VII_Mobiliteti i studentëve_Të dhëna të plota për kërkimin shkencor; Evidencë 4.19_Dosje e leksioneve dhe aktiviteteve të Departamentit).</b></li> </ul> <p><i>Gjithashtu GVJ, nuk gjen studentë nga programi i studimit Master i Shkencave “Etika dhe lidershipi në institucione”, përveç vitit 2020 ku ka qenë vetëm një studente fituese, por kjo nuk i përket programit që po analizojmë.</i></p>



<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Bashkëpunimet me institucione të ndryshme kanë rritur mundësinë për stafin akademik për të ndërthurur si format e mësimdhënies ashtu edhe për të rritur mobilitetin si të vetë stafit akademik, ashtu edhe studentëve. <b>(Evidencë 2.24 Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studentëve; Evidencë 3.5 Strategjia e zhvillimit të programit; Evidencë 3.18 Raport për veprimtarinë e programit të studimit).</b> Organizimi i konferencave, ëorkshop-ve, trajnimeve dhe leksioneve të hapura është një tjetër mundësi për mobilitet të studentëve të huaj dhe personel akademik <b>(Evidencë 4.7 Të dhëna për veprimtaritë kërkimore)</b></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p><b>Standardi V.8</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>UT ka krijuar strukturat dhe procedurat e posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin ndaj studentëve si Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e informacionit, Sekretaria Mësimore, por edhe stafet akademike të këtij program studimi, me të cilët GVJ pati takime ne institucion. Ato kryejnë funksione në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UT, për shërbimet e kërkuara nga studentët që nga regjistrimi, deri në diplomimin <b>(Evidencë 3.6 Rregullore e Programit të studimit; Evidencë 2.25 Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Shërbimit të Karrierës).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Të gjitha shërbimet e strukturave administrative në UT, si dhe zyrave në shërbim të studentit janë tregues i një sistemi të posaçëm për informimin, këshillimin dhe përparimin e studentëve. GVJ konfirmon se studentët marrin gjithë shërbimet e kërkuara që nga informimi, këshillimi dhe asistimi për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe për aktivitete e shërbime brenda e jashtë institucionit, për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore. <b>(Takime në institucion me studentët, përfaqësues së zyrrës së shërbimit dhe karrierës)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe</p>	<p>Institucioni përmes Zyrës së Shërbimit të Karrierës, mbështet çdo studentë aktual apo dhe të diplomuar, të këtij program studimi, nëpërmjet informimit, orientimit, trajnimit dhe këshillimit, që dhe pas diplomimit të shfrytëzojnë kapacitetet e tyre intelektuale për zhvillimin e një karriere sa më të suksesshme e për të qenë sa më konkurrues për tregun e punës. Gjithashtu kjo njësi, informon studentin e vitit të fundit</p>




periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	për mundësinë e arsimimit të mëtejshëm dhe zhvillimit profesional (Evidencë. 2.25_Rregullore e shërbimit të Karrierës).		
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Shërbimit dhe Karrierës, angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë ciklit të studimeve dhe ndjek punësimin e studentëve të diplomuar. Institucioni zotëron statistika mbi punësimin e studentëve të diplomuar në programet e studimit që ofron Departamenti i Filozofisë, ku në evidencat shoqëruese të RVB-së, gjetëm të specifikuar numrin e studentëve të punësuar në këtë program studimi. (Evidencë 4.8_Të dhëna për regjistrimin, ecurinë; Evidencë 4.14_Të dhëna për punësimin real të studentëve; Evidencë 4.17_Studimi i Tregut të Punës)		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X


## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi VI.1</b>	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore	Në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është parashikuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Në statutin e Institucionit (Evidencë 1.2_Statuti i UT) janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Komisioni i Përhershëm Për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) (Evidencë 1.2 Neni 41_Statuti i UT) dhe në



<p>institucionale.</p>	<p>rregulloren e sigurimit të cilësisë në UT - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) (<b>Evidencë 1.6_Rregullore e sigurimit të cilësisë në UT</b>), ku nga 11 anëtarë që përbëhet ky komision, një përfaqësues është nga njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Sociale. Pjesë e organizimit dhe funksionimit të këtij komisioni është dhe Komiteti i Sigurimit të Cilësisë (KSC), NJSBC në nivel fakulteti (<b>Evidencë 2.12_Vendimi i FSHS-së për ngritjen e NJSBC-së</b>). KKPSSC-ja është organ kolegjal, funksionet e së cilës i garanton veprimtaria e Senatit Akademik të UT (<b>Evidencë 1.2, Neni 31_Statuti i UT</b>) dhe ka për detyrë paraqitjen e informacioneve dhe vlerësimeve për procesin e mësimdhënies, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe është përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, duke rekomanduar edhe masa për përmirësimin e parametrevë të cilësisë në të ardhmen. Procesi i vazhdueshëm i monitorimit dhe vlerësimit për përmirësimin e cilësisë është edhe në objektivat strategjike dhe vizionin e institucionit (<b>Evidencë 1.4_Strategjia e Zhvillimit të UT</b>). GVJ, nga takimi me përfaqësues të kësaj zyre në institucion, konfirmon procedurat standarde të UT për vlerësimin e cilësisë dhe promovimin e stafit akademik të përcaktuara në Rregulloren e tij (<b>Evidencë 1.6_Rregullore për sigurimin e cilësisë UT</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në planin e tij strategjik (<b>Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT</b>) për 5 vjeçarën 2018 – 2023, Institucioni ka prioritet të tij garantimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Për të siguruar dhe ndjekur politikat e vlerësimit, si dhe në zbatim të procedurave të menaxhimit të cilësisë, FSHS-ja ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë i përbërë nga 5 anëtarë, ku në vitin 2021 në përbërje të këtij komisioni përfshihet dhe një studente. (<b>Evidencë 2.12_Vendimi i FSHS-së për ngritjen e Njësies së Sigurimit të Cilësisë; 3.5, pika 7.6_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Msc-Etika në institucione dhe lidhshëm</b>” 2021-2024)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, përdor mekanizma formale për shqyrtimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimeve, synon të rrisë ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve për rëndësinë e cilësisë, harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Institucioni, nëpërmjet Senatit Akademik përdor strukturat e brendshme për realizimin e sigurimit të cilësisë. Këto i ka siguruar nga miratimi i “Manualit të Cilësisë” (<b>Evidencë 1.11</b>) dhe “Paketa e Instrumenteve të Cilësisë” (<b>Evidencë 1.14</b>). Njësia kryesore dhe ajo bazë, nëpërmjet NJSBC-së, kryen monitorimin dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. Një element i rëndësishëm është dhe angazhimi i studentëve në këtë proces, kjo në funksion të përmirësimit të parametrevë të cilësisë në të ardhmen si dhe bën të mundur hartimin e</p>



	<p>anetimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat realizohen në fund të çdo semestri ose përpara fillimit të sesioneve të provimeve. <b>(Evidencë 2.12_Vendim i FSHS-së për ngritjen e NjSBC-së)</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni ndjek një politikë të vetën për sigurimin e cilësisë e lidhur kjo me tërësinë e qëllimeve dhe parimeve, rregullave që institucioni përdor për të zbatuar vendimet dhe veprimet e veta gjatë procesit të sigurimit të cilësisë, si kurs trajnimi për certifikatë në mësimdhënie në arsimin e lartë; kurse të shkurtra (sipas nevojave të identifikuara dhe në mbështetje të zbatimit të risive pedagogjike); Konferenca, seminare, shkolla verore dhe ditët e informimit; Ditët e zhvillimit profesional të cilat organizohen në bazë Fakulteti ose Departamenti <b>(Evidencë 2.21_Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik)</b>. Gjatë vizitës në institucion <b>(Takimi me anëtare të NjSBC-së dhe Zyrës së Karrierës)</b> GVJ konfirmoi se ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë si pyetësorët për vlerësimin e pedagogëve dhe studentëve që aplikohen periodikisht për përmirësimin e procesit mësimor, duke krijuar kulturën e rritjes së cilësisë në nivel institucional.</p> <p>Gjithashtu, me anë të këtyre instrumenteve, realizon dhe evidenton vlerat apo nevojat për përmirësimin e programit të studimit, stafit akademik dhe të gjithë aktorëve të tjerë mbështetës në këtë proces, në mënyrë periodike, të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik/lëndët e zhvilluara dhe pëlqyeshmërinë ndaj tyre <b>(Evidencë 1.14_Paketa e instrumenteve të cilësisë)</b>;</li> <li>2. Formularët me stafin akademik <b>(Evidencë 1.14_Paketa e instrumenteve të cilësisë)</b> <b>(Evidencë 1.13_Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik)</b>.</li> </ol>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë, manualin dhe udhëzimet e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitat e Statutit dhe të Rregullores Bazë të UT, institucioni ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe Komisionin e Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë (KPSSC) për vlerësim në nivel institucioni, të</p>




	<p>cilët hartojnë politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë, shprehur edhe në Statutin e UT (<b>Evidencë 1.2, Kreu III, neni 41, 42</b>); <b>Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë 1.6, Kreu III, Neni 15_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</b>). Gjatë takimeve në institucion me përgjegjësen e departamentit, koordinatorin e programit të studimit, stafin akademik, dhe përfaqësues të NjSBC në nivel njësie kryesore (FSHS), GVJ konfirmoi se këto janë struktura kryesore që merren me shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidhshëm”. Në funksion të garantimit të cilësisë, Departamenti ka caktuar koordinatorin e programit të studimit (<b>Evidencë 3.11_Vendim për caktimin e koordinorit të programit të studimit</b>) i cili ka detyra specifike e që lidhen me çështjet e rishikimit të kurrikulës, përgjegjësi të parashikuara në rregullore (<b>Evidencë 3.12_Përshkrimi i detyrave të Koordinatorit të Programit të Studimit</b>). Rishikimi dhe përditësimi i programit të studimit është një proces që GVJ evidentoi gjatë takimeve në institucion (<b>Evidencë Takimi me koordinatorin e programit, përgjegjësen e departamentit dhe personel akademik</b>) por edhe nga dokumentacioni i venë në dispozicion (<b>Evidencë 2.16_Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit; Evidencë 3.15_Procedurat e përmirësimit të kurrikulës</b>). Këto ndryshime lidhen si me përditësimin e syllabuseve, ashtu edhe me përditësimin e programit të studimit në tërësi. Departamenti i Filozofisë ka hartuar edhe strategjinë e zhvillimit të programit të studimit 2021-2024 (<b>Evidencë 3.5_Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Filozofisë, një vëmendje të veçantë i kushton sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke përdorur mekanizma të ndryshëm lidhur me programin e studimit që po analizojmë. Njësia bazë, në bashkëpunim edhe me NjSBC-në, i shfrytëzojnë këto mekanizma për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e programit të studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidhshëm” (<b>Evidenca 1.11_Manuali i cilësisë; Evidencë 3.2_Strategjia e Departamentit të Filozofisë; Kreu IV. Prioritetet strategjike dhe rezultatet e pritshme</b>). Për këtë proces angazhohen dhe strukturat akademike në rishikimin e programeve lëndore (syllabuseve) (<b>Evidencë 3.15_Procedurat e përmirësimit të kurrikulës; Evidencë 2.16_Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidencë 4.1_Korniza konceptuale e programit të studimit</b>). GVJ, gjatë takimeve në institucion (<b>Evidencë_Kordinatori programi, GVB, përgjegjës departamenti</b>), por edhe shqyrtimit të dokumentacionit bashkëngjitur dosjes së vlerësimit të brendshëm, evidentoi se në departament ndiqet si praktikë vlerësimi i programit të studimit, anketimet me studentët, të cilët vlerësojnë lëndët,</p>







	<p>mësimdhënien, performancën e stafit akademik, infrastrukturën etj. <b>(Evidencë 3.18.1/2_ Raporti vjetor për veprimtaritë e zhvilluara në DF)</b>. Kjo procedurë është e përcaktuar në Rregulloren e NJSBC dhe Përshkrimin e veprimtarisë së NJSBC-së <b>(Evidencë 2.14 dhe Evidencë 2.13)</b>. Mekanizmat dhe proceset formale e të dokumentuara për monitorimin e programeve të studimeve të ciklit të parë i gjetëm në dokumentat e administruara nga njësia bazë dhe kryesore. Njësia bazë pasi identifikon nevojën për riorganizim të programit të studimit e diskuton dhe e miraton atë brenda departamentit. Më pas kjo i kalon për miratim Dekanit të FSHS-së, Rektorit dhe finalizohet në MAS. Për ndryshimet të cilat nuk kalojnë në masën 20%, vendimi për miratim i takon Senatit Akademik. <b>(Evidencë 2.16_ Informacion për politikat e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave; Evidencë_3 dokumenta shtesë; Evidencën 1.6, Neni 31_Regullore e sigurimit të cilësisë në UT; Evidencë 2.14, Neni 21_Regullore e sigurimit të cilësisë për FSHS)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni realizon aktivitete me karakter monitorues për vlerësimin në nivel institucional të programit të studimit. Sistemi i instaluar (anketimi i studentëve) dhe funksionimi me struktura të lidhura janë tregues të metodologjisë së vlerësimit. Nëpërmjet politikave të zhvillimit, koordinon, drejton dhe kontrollon aktivitetet e mësimdhënies dhe kërkimit, vlerëson efektivitetin e tyre dhe vendos për probleme të rëndësishme që lidhen me programin e studimit, të gjitha këto në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe dokumentat rregullatore të Universitetit <b>(Evidencën 1.6, Neni 15 Metodologjia e punës e NjSC_Regullore e sigurimit të cilësisë në UT; Evidencë 1.14_Paketa e instrumentave të cilësisë; Evidencë 2.14, Neni 21_Regullore e sigurimit të cilësisë për FSHS; Evidencë 2.15_Politikat e sigurimit të cilësisë në FSHS; Evidencë 3.15_Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit Master i shkencave )</b>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Lidhur me aktivitetet me karakter monitorimi, për secilën nga proceset akademike që zhvillohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre, institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta apo të tërthorta, ku përfshihen stafet akademike dhe ndihmës akademike, studentët e programit të studimit, koordinatori i programit. Njësia kryesore dhe njësia bazë, përgjegjëse e programit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidërsip”, si dhe NJSBC hartojnë një analizë periodike në fund të vitit akademik <b>(Evidencë 2.18_Analiza vjetore e FSHS; Evidencë 3.18_Raport vjetor i DF)</b>. Njësia kryesore ka përgjegjësinë për komunikimin e rezultateve dhe vlerësimeve për aktorët përgjegjës, të cilat u bëhen me dije stafit akademik dhe autoriteteve vendimmarrëse, rezultate këto që lidhen drejtpërdrejtë me performancën e tyre <b>(Evidencë 1.6, Neni 22</b></p>




	<b>Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit _Rregullore e sigurimit të cilësisë).</b>		
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Pas analizës së pyetësorëve në nivelet përkatëse dhe diskutimeve me personat e interesuar, institucioni merr masa për zgjidhjen e problematikave nëse ka. Programi i studimit përmirësohet në bazë të rezultateve të vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe studentët. Pasi merren rezultatet e anketës së studentëve, bëhet rivlerësimi i përmbajtjes së lëndës në bazë departamenti, që i përcillet për miratim Dekanatit dhe për miratim përfundimtar Senatit ( <b>Evidencë 1.3_Regullore e UT; Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT; Evidencë 2.4_Rregullore e FSHS</b> ). Këto raporte vlerësimi përfshijnë tregues kyç të performancës për të analizuar kontributin e punës në arritjen e objektivave strategjike institucionale të cilat janë pjesë e komunikimit dhe diskutimeve në nivel njësie bazë, dhe kryesore.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Raportet e vlerësimit të brendshëm hartohen në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin që ofron programin e studimit. Baza e analizës për vlerësimin e brendshëm janë të gjithë dokumentet dhe raportimet e hartuara nga njësia bazë dhe njësitë e tjera. Në kuadër të këtij vlerësimi, ngrihet dhe funksionon GVB-ja e cila të gjithë veprimtarinë e vet e mbështet në procedurat e parashikuara në Manualin e Cilësisë të UT dhe udhëzimet e ASCAL ( <b>Evidencë 2.14, Neni 16,17,18_Rregullore e sigurimit të cilësisë ne FSHS; Evidencë 1.11_Manuali i cilësisë</b> ). Grupet ad-hoc të vetëvlerësimit të brendshëm përbëhen nga anëtarë të njësisë bazë që ofron programin, anëtarë të stafit akademik dhe 1 përfaqësues nga studentët, sikurse u verifikua nga GVJ gjatë takimeve me ta në institucion dhe dokumentacionit të DVV.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Institucioni ka një sistem të vlerësimit me metoda dhe instrumente të unifikuara ( <b>Evidencë 1.6, Neni 21_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</b> ), ndërsa vetë njësia bazë përdor edhe instrumente specifike që pasurojnë informacionin e mbledhur për vlerësimin e programit të studimit. Nga biseda me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik dhe koordinatoren e programit të studimit, rezultoi se në mbledhjen e departamentit ata analizojnë dhe vlerësojnë ecurinë e programit të studimit në tërësi, monitorimin e procesit të provimeve, përditësimin e



	<p>programeve të lëndëve, literaturën e përdorur, nëse janë të përditësuara (5 vitet e fundit), etj. Instrumentet kryesore që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe pyetësorët, fokus grupet, raportet e kërkimit shkencor në nivel departamenti për programin e studimit, përfaqësimi në KSC, etj. Këto vlerësime (pyetësorë) zhvillohen dy herë në vit në fund të semestrit të 1, 2 përpara nisjes së sesioneve të provimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe takimeve në institucion (<b>Evidencë Takimi me anëtarë të GVB-së, Zyrën e Kurrikulave dhe personelin akademik</b>) GVJ konstatoi se për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programeve të studimit, krahas formave të larmishme të përmendura më sipër, përdoret edhe vlerësimi i pedagogëve për njëri tjetrin nëpërmjet formularëve të vetëvlerësimit. (<b>Evidencë 1.13_Manuali i vlerësimit të performancës për personelin akademik; Evidencë 4.18_Raporti i vlerësimit të pedagogëve nga studentët</b>). Gjatë takimeve në institucion me GVB dhe përgjegjësen e departamentit na u konfirmuan të dhëna mbi individët e angazhuar në komisionin e sigurimit të cilësisë apo të NjsBC-së, të mbledhjeve në departament për ecurinë e procesit mësimor, vlerësimi paraprak i tezës së provimit nga drejtuesi i departamentit sipas formatit të standardizuar; mentorimi për mikrotezën e diplomimit, apo dhe vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës profesionale. Një praktikë e mirë konsiderohet raporti vjetor i departamentit i cili përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore të hollësishme mbi çështje që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, vetëvlerësimin e stafit akademik, rezultatet e arritura të studentëve, financimi i aktiviteteve të zhvilluara dhe kërkimi shkencor, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaritë shkencore etj. Departamenti evidenton elementët që lidhen me programin e studimit dhe i bën pjesë të vetëvlerësimit në kuadër të akreditimit të programit të studimit dhe atë institucional (<b>Evidencë 1.6_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që</p>	<p>Nga biseda me stafet drejtuese të institucionit dhe shqyrtimi i DVV rezulton se në nivel institucioni dhe në nivel njësie bazë përdoren edhe metoda të tërthorta për vlerësimin e ecurisë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit si: monitorimi i syllabuseve nëse janë konform formateve të përcaktuara nga VKM dhe Departamenti, rezultatet e studentëve në provime dhe në detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup, rezultatet e praktikës profesionale dhe të punimit të diplomave, si dhe rezultatet e punësimit të studentëve.</p> <p>Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë, aktualisht i përbërë nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Sigurimit për vlerësim institucional, ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e parametrevave të cilësisë në gjithë veprimtarinë mësimore e kërkimore – shkencore të Institucionit, duke u bazuar në Standardet shtetërore të cilësisë, si dhe në Manualin për “<i>Procedurat dhe afatet për vlerësimin e</i></p>




shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program	<p><i>cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit</i>". Institucioni, nëpërmjet NjSBC-së, përdor metoda të tërthorta vlerësimi, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit);</li> <li>▪ Fokus grupe (në muajin dhjetor) mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj. (<b>Evidencë 4.18_Raporti i vlerësimit</b>).</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi VL4


**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Universiteti i Tiranës ka hartuar dhe zbatuar një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si pjesë e strategjisë së saj ( <b>Evidencë 1.4_Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023</b> ). Gjithashtu, në dokumentet themelore si Statut, Rregullore, Strategji e Universitetit, janë të parashikuara strukturat përgjegjëse për realizimin e procedurave të brendshme të cilësisë dhe garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar në këtë proces. Realizimi i instrumenteve të matjes së cilësisë si pyetësorë, fokus-grupe, anketa, formularë janë mekanizma që sigurojnë përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit ( <b>Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.3_Rregullore e UT; Evidencë RVB, fq. 99</b> )
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësitë dhe detyrat e njëjsteve të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin Master i Shkencave "Etika në Institucione dhe Lidhshmëri" janë të përcaktuara në kuadrin ligjor mbi të cilin funksionon UT dhe në dokumentet institucionale që rregullojnë veprimtarinë e lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë ( <b>Evidencë 1.6, Kreu III, Neni 13_Rregullore e sigurimit të cilësisë në UT</b> ). Më konkretisht, Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë drejtues i UT, dhe që përmbush këto përgjegjësi lidhur me sigurimin e cilësisë. Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë (KPSSC) dhe Njësia e sigurimit të cilësisë (NjSC) në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet, ushtrojnë dhe kanë lirinë e plotë për të identifikuar problematikat e programit të studimit dhe të marrin nisma për ti tejkaluar ato. Komisioni i përhershëm i kurrikulave i Senatit Akademik të UT dhe Drejtoria e Kurrikulave në UT bashkëpunojnë ngushtë me KPC dhe NjSC për



	sigurimin e cilësisë të programeve të studimit. Njësia e Sigurimit të Cilësisë nëpërmjet grupit ad hoc në nivel njësie bazë, monitoron zbatueshmërinë e këtyre standardeve tek strukturat dhe funksionimi i stafit akademik dhe atij administrativ në tërësi. Këto struktura nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive akademike, kërkimore shkencore dhe administrative që ushtrohen në institucion, janë fokus i një përmirësimi të vazhdueshëm të punës së këtij institucioni ( <b>Evidencë 1.11, pika 3.1_Manuali i Cilësisë</b> ).			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademiq e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Në Manualin e Cilësisë si dhe në Planin Strategjik, cilësohet se: <i>të gjitha organizmat kanë lirinë dhe autoritetin të identifikojnë problemet, marrin nisma, japin rekomandime dhe paraqesin zgjidhje për çështje të cilësisë.</i> ( <b>Evidencë 1.11 pika 2</b> ). Gjithashtu përgjegjësi i njësive kryesore dhe bazë, personeli akademik dhe ndihmës akademik, stafi ndihmës administrativ dhe studentët, janë të përfshirë dhe përgjegjës në kuadër të sigurimit të cilësisë të programit të studimit ( <b>Evidencë 1.11, pika 2.8, 2.9, 2.11, 2.12_Manuali i Cilësisë</b> ). Po ashtu, përfaqësues në GVB, me të cilët GVJ realizoi takimin gjatë vizitës në institucion, si dhe metodologjia dhe procesi i hartimit të RVB tregojnë përfshirjen e të gjithë aktorëve në këtë proces. ( <b>Evidencë 2.17_Të dhënat tabelore për njësitë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë, Vendim i Dekanit të FSHS për ngritjen e GVB-së 2022</b> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Institucioni ka përcaktuar standarde ( <b>Evidencë 1.11_Manuali i cilësisë</b> ) që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset ciklike të vlerësimit të tilla si: kompetencat profesionale; paanshmëria; qasja në informacionet për të kryer vlerësimin ( <b>Evidencë 3.6, Kreu IX Neni 33_Rregullore e programit të studimit</b> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Gjatë shqyrtimit të DVV, GVJ konstaton përfshirje të drejtpërdrejtë të bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm me proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, në nivel programi studimi. Gjithsesi, personeli i jashtëm akademik, i angazhuar në programin e studimit, sikurse dhe ky proces vlerësimi i jashtëm që po i nënshtrohet programi për herë të parë, janë element që ndikojnë në përfshirjen e aktorëve të tjerë në procesin e sigurimit të cilësisë ( <b>Evidencë 3.19_Raport analitik mbi marrëveshjet e bashkëpunimit</b> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	







**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Sistemi i sigurimit të standardeve të cilësisë në UT funksionon në bazë të dokumenteve dhe rregullave institucionale, të cilët përcaktojnë politikat dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Njësia kryesore në fund të çdo viti akademik harton Analizën Vjetore të punës. Të dhënat bëhen publike dhe të aksesueshme për studentë dhe palë të tjera të interesuara, si dhe në faqen zyrtare të UT. <b>(Evidencë 1.2_Statuti i UT; Evidencë 1.6_Rregullore për SC-së).</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Komisioni për Sigurimin e Brendshëm i Cilësisë në UET ka të përcaktuara parime që sigurojnë garantimin e transparencës, informimin e personelit dhe studentëve mbi raportet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, duke respektuar Kodin e Etikës dhe Rregulloret e UT <b>(Evidencë 1.6, Neni 21_Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; Raportet e vlerësimit institucional gjenden në seksionin e dedikuar sigurimit të cilësisë, në faqen zyrtare të FSHS (<a href="https://fshs-ut.edu.al/">https://fshs-ut.edu.al/</a>))</b>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Gjatë shqyrtimit të dokumentave të dosjes së vetëvlerësimit, të gjithë pyetësorët e plotësuar janë përpunuar, me metoda cilësore dhe sasore, në varësi të llojit të pyetjes. Problemet që janë evidentuar nuk kanë qenë esenciale të lidhura me stafin akademik, stafin administrativ apo literaturën që përdorin. Departamenti i Filozofisë, në përfundim të analizës së pyetësorëve nxjerr konkluzionet dhe rekomandimet, plan masash të cilat lidhen me përmirësimin e cilësisë për procesin e mësimdhënies, performancës së tyre, infrastrukturës etj. <b>(Evidencë 2.18_Raport vjetor i Departamentit).</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Analizat periodike dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë mundësojnë përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Stafi akademik dhe studentët e programit të studimit Master i Shkencave “Etika në Institucione dhe Lidhshmëri”, gjatë takimeve me GVJ-në, shprehën gatishmërinë dhe vullnet të mirë për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, nisur nga analiza vjetore e punës që vetë departamenti hartonte, por edhe më gjerë nga rekomandimet e mundshme të vlerësimit të jashtëm nga ASCAL <b>(Vizita në Institucion, takimi me personelin akademik dhe studentët e programit).</b>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe	Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese sqaron studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit, avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe vlerësimi institucional.



ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Institucioni ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore - shkencore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të Universitetit ( <b>Evidencë 1.4_Strategjia e UT, pika 4, fq. 17</b> ). GVJ nga takimet me studentët dhe personelin akademik konstatoi, Institucioni organizonte takime të hapura, në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke i informuar ata dhe duke nxitur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave  
“Etika në Institucione dhe Lidërsip”, të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i  
Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Përmbajtja e programit të studimit dhe rishikimi periodik i planit mësimor në bashkëpunim me studentët dhe përfaqësues nga tregu i punës, mundëson pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
2. Angazhimi i personelit akademik në veprimtari kërkimore-shkencore, të tilla si botimi i artikujve shkencor, monografive, pjesëmarrja në konferenca shkencore.
3. Organizimi i aktiviteteve shkencore dhe ekstrakurrikulare nga njësi bazë dhe kryesore, me përfshirjen e personelit akademik, studentëve dhe partnerët bashkëpunues.
4. Numri i studentëve që ndjekin programin e studimit ka qenë konstant duke siguruar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e programit. Fokusi më shumë teorik dhe kërkimor në nivelin Master i Shkencave bën dallimin cilësor me studimet e nivelit Bachelor, ku një rol të rëndësishëm luan kurrikula dhe aktualizimi i saj.
5. Ofrimi i programit edhe në gjuhën angleze është në përputhje me prioritetin e ndërkombëtarizimit, prioritet në nivel IAL dhe Departamenti dhe ndikon në lehtësimin e mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve, sikurse ndikon edhe në rritjen e aftësive të studentëve të këtij programi për t'u përshtatur më lehtë me tregun e punës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
6. Aplikimi i një sistemi vlerësimi të vazhdueshëm dhe kombinimi i formave të ndryshme të vlerësimit, bazuar në specifikat e secilës lëndë.

**Pika të dobëta:**

1. Mungesa e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës që lidhet drejtpërdrejt me programin e studimit Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidërsip” (**Standardi I.3, kriteri 2**).
2. Mungesa e lëndëve për përgatitje metodologjike në kategorinë A (**Standardi II.1, Kriteri 6**).
3. Angazhimi në mësimdhënie i personelit akademik me MSc. në një program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe angazhimi si titullarë lëndësh i personelit akademik që jo gjithmonë i përket kategorisë “Profesor”, sikurse kërkohet nga dispozitat ligjore në fuqi (**Standardi II.5, kriteri 1 dhe 2**).
4. Ngarkesa mësimore e këtij programi studimi nuk mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv, si dhe në disa raste, personeli akademik është i angazhuar në 7 lëndë, në programe të ndryshme studimi, duke mos respektuar kështu dispozitat ligjore në fuqi (**Standardi II.5, kriteri 1 dhe 2**).
5. Nuk evidentohen raste konkrete të bashkëpunimit midis Departamentit dhe aktorëve të tjerë, të cilat të kenë ardhur si rrjedhojë e kërkesës së paraqitur nga aktorët e jashtëm për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor (**Standardi II.8, kriteri 2**).





6. Mungesa e një sistemi të menaxhimit të informacionit në të cilin të jenë të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve (**Standardi IV.5, kriteri 4 dhe 5**).


#### **Rekomandime:**

1. Institucioni, të marrë masa për të realizuar një studim tregu për programin Master i Shkencave në “Etika në Institucione dhe Lidërsip”.
2. Institucioni, të zëvendësojë njërën nga lëndët ekzistuese në Kategorinë A me një lëndë për përgatitjen metodologjike (Metoda Kërkimi), si dhe në kategorinë D të shtohet një lëndë ose të rritet ngarkesa e praktikës profesionale, me qëllim që ngarkesa totale e kësaj kategorie të jetë në përputhje me parashikimet e akteve nënligjore në fuqi.
3. Institucioni, të marrë masa për angazhimin në mësimdhënie në këtë program studimi vetëm të personelit akademik me grada shkencore dhe tituj akademik, si dhe angazhimin si titullarë lëndësh të personelit akademik me titullin “Profesor”, sikurse kërkohet nga dispozitat ligjore në fuqi.
4. Institucioni, të marrë masa për mbulimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit nga personel akademik efektiv, në masën të paktën 70 %, si dhe të respektojë dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi lidhur me numrin e lëndëve ku angazhohet personeli akademik i këtij programi studimi.
5. Institucioni, të angazhohet në rritjen e nivelit të bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, në funksion të ofrimit dhe realizimit të analizave, studimeve e projekteve me karakter kërkimor shkencor.
6. Institucioni, të marrë masa për vënien në përdorim të një sistemi të menaxhimit të informacionit, të integruar me platforma dhe module.

#### **Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science “Ethics in Institutions and Leadership” of the Institution of Higher Education “University of Tirana”**

#### **Strengths and Affirmations:**

1. The content of the study program and the periodic review of the curriculum in cooperation with students and representatives from the labour market, equips students with the necessary knowledge in accordance with the requirements of the labour market.
2. Engagement of academic personnel in research-scientific activities, such as the publication of scientific articles, monographs, participation in scientific conferences.
3. The organization of scientific and extracurricular activities by the basic and main unit, with the involvement of academic staff, students and cooperating partners.
4. The number of students following the study program has been constant, ensuring the stability and continuity of the program. The more theoretical and research focus at the






- Master of Science level makes a qualitative difference with Bachelor level studies, where an important role is played by the curriculum and its updating.
5. Offering the program also in English is in line with the priority of internationalization, a priority at the HEI and Department level, and affects the facilitation of the mobility of academic staff and students, as well as increasing the abilities of the students of this program to adapt more easily to the labour market at the national and international level.
  6. Application of a continuous evaluation system and the combination of different forms of evaluation, based on the specifics of each subject.

#### **Weaknesses:**

1. The lack of a genuine study of the labor market that is directly related to the Master of Science study program in "Ethics in Institutions and Leadership" (**Standard I.3, criterion 2**).
2. The lack of subjects for methodological preparation in category A (**Standard II.1, criterion 6**).
3. The engagement of academic staff with MSc. in a study program of the second cycle "Master of Science" and the engagement as subject holders of the academic staff not always of the "Professor" category, as required by the legal provision in force (**Standard II.5, criterion 1 and 2**).
4. The teaching load of this study program is not covered to the extent of at least 70% by effective academic staff, as well as in some cases, the academic staff is engaged in 7 subjects, in different study programs, thus not respecting the legal provisions in force (**Standard II.5, criterion 1 and 2**).
5. Concrete cases of cooperation between the Department and other actors, as a result of the request presented by external actors for analyses, studies and projects of a scientific research character are not identified (**Standard II.8, criterion 2**).
6. Lack of an information management system in which platforms and modules are integrated that enable forms of interactive communication and information exchange between staff and students (**Standard IV.5, criterion 4 and 5**).

#### **Recommendations:**


1. The Institution should take measures to carry out a market study for the Master of Science program in "Ethics in Institutions and Leadership".
2. The Institution should replace one of the existing courses in Category A with a course for methodological preparation (Research Method) and add a subject to category D or the load of professional practice be increased, in order for the total load of this category to be in accordance with the provisions of the legal acts in force.
3. The Institution should take measures to involve in teaching in this study program only academic staff with scientific degrees and academic titles and to engage as subject holders academic staff with "Professor" title, as required by the legal provisions in force.
4. The institution should take measures to cover the teaching load of the study program by effective academic staff, to the extent of at least 70%, as well as respect the legal and by-





law provisions in force regarding the number of subjects in which the academic staff of this study program are engaged.

5. The institution should be engaged in increasing the level of cooperation with external actors, in order to provide and carry out analyses, studies and projects with a scientific research character.
6. The institution should take measures for the implementation of the information management system, integrated with platforms and modules.





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen kryesisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

